



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 56 AKTI

NR. 62 VENDIMI

Tiranë, më 03.08.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Suela Zhegu	Anëtare
Pamela Qirko	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia LHE Roessingh-Bakels, më datë 31.07.2018, ora 11:15, në Pallatin e Kongreseve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Artur Malaj**, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (referuar më poshtë “Kushtetuta”);

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë “Ligji nr. 84/2016”);

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tria kriteret, vlerësimin pasuror, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë se ka kandiduar për Inspektor i Lartë të Drejtësisë, në bazë të nenit 282 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 30.11.2017 në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (referuar më poshtë “Komisioni”).

Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë, pasi janë caktuar me short trupat gjykues të Komisionit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete, më datë 30.11.2017.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 14.12.2017 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Genta Tafa (Bungo), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e këtij trupi, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Artur Malaj.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD). Këto raporte janë administruar nga relatori, me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 30.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit për subjektin e rivlerësimit ka konstatuar se:

- 1) deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- 2) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- 3) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- 4) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- 5) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 13.04.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur H. Malaj.*

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 29.12.2017.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 05.07.2018 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua më datë 06.07.2018 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më datë 09.07.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 20.07.2018.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, nëpërmjet *e-mail*-it, më datë 25.07.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më datë 31.07.2018, ora 11:15, në Sallën e Konferencave në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia LHE Roessingh-Bakels.

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, kërkoi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Artur Malaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Por, referuar Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017^[1] dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

^[1] “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga ana e subjektit në ILDKPKI; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (dh) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

Dokumentacioni i analizuar përbëhet nga:

- Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- Provat e depozituara nga subjekti pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;
- Informacionet dhe të dhënat e administruara nga ky Komision nëpërmjet organeve shtetërore, personave fizikë dhe juridikë;
- Shpjegimet dhe deklaratat e subjektit në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni;
- Shpjegimet, deklaratat e subjektit dhe provat shkresore të dërguara nga ana e tij në prapësimet e rezultateve të hetimit administrativ;
- Shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore nga ana e subjektit të rivlerësimit;
- Dëshmitë e marra nga ana e këtij Komisioni.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratimeve të interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar - “Vetting” të datës 31.01.2017, me nr. indeksi ***, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI, për vitet 2003 - 2016, në raport me të dhënat e Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar - “Vetting”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe të likuiditeteve - gjendje *cash*;
- d) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Në Deklaratën-Vetting, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

- 1. Tokë bujqësore-ullishte, me sip. 1500 m², e ndodhur në Mekat, Vlorë, përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” në përdorim. Pjesa që zotëron: 50 %.**

Për këtë aset, subjekti ka paraqitur:

- Aktin e marrjes së tokës në pronësi, nr. *** regj., datë 17.03.1995, tokë me sip. 1.500 m², fshati Mekat, në emër të familjes N.S.
- Certifikatë familjare, e datës 18.10.2016 (ku vërtetohet përbërja familjare e datës 01.10.1992, N.S. dhe Artur Malaj).
- Vërtetim nr. *** prot., i datës 13.10.2016, Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Vlorë.
- Certifikatë familjare, datë 30.01.2017.
- Certifikatë vdekjeje e N.S., datë 18.01.2017.

- ❖ *Komisioni konstaton se subjekti ka qenë i saktë në deklarin e tij. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar.*

- 2. Tokë bujqësore 3.500 m² (3.000 m² arë + 500 m² ullishte) në Mekat, Njësia Administrative Llakatund, Vlorë, përfituar me ligjin 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” në bashkëpronësi me N.S. (pronë e paregjistruar në ZVRPP Vlorë, pasi nuk ka kaluar regjistrimi fillestar). Pjesa që zotëron: 50 %. Bashkëngjitur deklaratës, kopje e noterizuar e Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, nr. regjistrimi të aktit ***, datë 17.03.1995, dhe akti i marrjes në përdorim nr. *** regj., datë 17.03.1995.**

Për këtë aset, subjekti ka paraqitur:

- Aktin e marrjes së tokës në pronësi, nr. *** regj., datë 17.03.1995, tokë me sip. 3.500 m², fshati Mekat në emër të familjes N.S.;
- Certifikatë familjare, e datës 18.10.2016 (ku vërtetohet përbërja familjare e datës 01.10.1992, N.S. dhe Artur Malaj);
- Vërtetim nr. *** prot., i datës 13.10.2016, nga Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Vlorë.
- Certifikatë familjare, datë 30.01.2017.
- Certifikatë vdekjeje e N.S., datë 18.01.2017

- ❖ *Komisioni konstaton se subjekti ka qenë i saktë në deklarin e tij. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar.*

- 3. Apartament banimi, me sipërfaqe 106.7 m², i ndodhur në Tiranë, në rrugën “***”, sot rruga “****”, pallati “****”, kati i *** nga toka, negociuar dhe prenotuar në vitin 2005 për një çmim rreth 55,000 (pesëdhjetë e pesë mijë) euro së bashku me garazh. Në vitin 2008, çmimi përfundimtar i apartamentit është caktuar 5,000,000 (pesë milionë) lekë, sipas aktmarrëveshjes dhe procesverbalit të marrjes në dorëzim të datës 15.05.2008. Bashkëpronësi me bashkëshorten nga ½ pjesë ideale.**

Burimi i krijimit në Deklaratën-Vetting:

Kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”, me vlerë 5,000,000 (pesë milionë) lekë.

Si dhe:

4. Garazh, me sipërfaqe 16 m², i ndodhur në rrugën “****”, sot rruga “****”, pallati “****”, Tiranë. Blerë në vitin 2008. Bashkëpronësi me bashkëshorten nga ½ pjesë ideale. Vlera e tij, deklaruar 500,000 (pesëqind mijë) lekë.

Burimi i krijimit në Deklaratën-Vetting:

Kursime nga paga e tij dhe nga të ardhurat e bashkëshortes nga biznesi i noterisë.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me pasuritë apartament dhe garazh

Referuar deklaratës periodike vjetore të vitit 2005, të dorëzuar në ILDKPKI më datë 20.03.2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *prenotimin e apartamentit me sipërfaqe rreth 102 m², të ndodhur në rrugën “****”, me kontratë sipërmarrjeje me firmën “****”, të lidhur më datë 31.05.2005.* Sipas këtij vetëdeklarimi, vlera e këtij apartamenti është në shumën prej 55,000 eurosh dhe se nga ana e subjektit është paguar shuma prej 5,000,000 lekësh, që përkon me vlerën e marrjes së kredisë.

ZVRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 19.01.2018, konfirmon se nëpërmjet kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.10.2008, të redaktuar nga notere N. K., subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. apartamentin nr. ***, kati i ***, me sipërfaqe 106.7 m², të ndodhur në godinën ***, ***, *** dhe *** kat, me një kat parkim nën tokë, në rrugën “****”, zona kadastrale ***, me nr. pasurie ***, volumi ***, faqe ***.

Referuar kësaj kontrate noteriale, shitësi “****” sh.p.k. ia shet pronën e përshkruar më sipër blerësve Artur dhe L.M., nga ku me marrëveshje, të dyja palët kanë përcaktuar se çmimi për këtë shitblerje është 46,860 lekë për metër katror, ose në një shumë të përgjithshme për apartamentin prej 5,000,000 lekësh, shumë e cila është likuiduar totalisht nga blerësit jashtë zyrës noteriale.

Nga dokumentacioni i administruar nga ZVRPP-ja Tiranë konfirmohet se, me anë të kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.10.2008, të redaktuar nga notere N.K., subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. garazh me sipërfaqe 16 m², të ndodhur në godinën ***, ***, *** dhe *** kat, me një kat parkim nën tokë në rrugën “****”, zona kadastrale ***, me nr. pasurie ***, volumi ***, faqe ***.

Referuar kësaj kontrate noteriale, shitësi “****” sh.p.k. ia shet pronën e përshkruar më sipër blerësve Artur dhe L. M., nga ku me marrëveshje të dyja palët kanë përcaktuar se çmimi për këtë shitblerje është 31,250 lekë për metër katror, ose në një shumë të përgjithshme për njësinë prej 500,000 lekësh, shumë e cila është likuiduar totalisht nga blerësit jashtë zyrës noteriale.

Konstatohet se këto dy kontrata në asnjë rast nuk i referohen ndonjë kontrate prenotimi/sipërmarrjeje, të nënshkruar më herët nga palët.

Me dorëzimin e Deklaratës - Vetting, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar një dokument, **aktmarrëveshje dhe procesverbal i marrjes në dorëzim, i datës 15.05.2008**, lidhur ndërmjet tij dhe shoqërisë “****” sh.p.k., ku ndër të tjera parashikohet se:

- a) Në godinën e ndërtuar nga shoqëria “****” sh.p.k., porositi (subjekti i rivlerësimit) ka negociuar dhe prenotuar një apartament banimi dhe një garazh që në muajin maj të vitit 2005, kur sapo kishte filluar ndërtimi i kësaj godine, me një çmim rreth 55,000 euro, i negociueshëm;

b) Duke qenë se porositësi dhe shoqëria ndërtuese ranë dakord që:

- sipërfaqja e apartamentit të ishte 117.5 m²;
- sipërfaqja e garazhit të ishte 16 m² dhe i mbyllur;
- banesa të dorëzohej e përfunduar në maj të vitit 2006,

- ndërsa në ditën e nënshkrimit të kësaj aktmarrëveshjeje dhe procesverbalit të marrjes në dorëzim, porositësi ka konstatuar këto mangësi:

- sipërfaqja e apartamentit nuk është 117.5 m² sa kishin rënë dakord, por 106.7 m², pra 10.8 m² më pak;
- pllakat e apartamentit në të gjithë sipërfaqen e tij ishin të pashtruara;
- sipërfaqja e garazhit ishte 16 m², por nuk kishte mure rrethuese dhe as qepen, por ishte një sipërfaqe e hapur pa ndarje;
- apartamenti nuk ishte përfunduar ende në momentin e nënshkrimit të kësaj aktmarrëveshjeje,

- palët kanë rënë dakord që vlera përfundimtare e shitjes së apartamentit të jetë 5,000,000 lekë, shumë e cila është likuiduar nga porositësi (*subjekti i rivlerësimit*) që në vitin 2005, si edhe vlera e garazhit do të jetë 500,000 lekë, vlerë e cila nuk u likuidua menjëherë nga porositësi, por do të likuidohet kur shoqëria ndërtuese ta regjistronte objektin në ZRPP dhe të pajisej me certifikatë pronësie.

✓ *Konstatohet se, megjithëse subjekti i rivlerësimit, sikurse në DPV/2005, ashtu edhe me anë të dorëzimit të kësaj aktmarrëveshjeje, i referohet një kontrate porosie të nënshkruar me shoqërinë “****” sh.p.k. në vitin 2005, ai nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion justifikues lidhur me këtë kontratë.*

Nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, konfirmohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij (bashkëkredimarrëse) kanë lidhur kontratën e kredisë bankare me “Raiffeisen Bank”, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 06.09.2005, të redaktuar nga notere G.Sh., sipas së cilës banka ka rënë dakord t’i japë kredimarrësit shumën deri në 5,000,000 lekë dhe se qëllimi i dhënies së kredisë është për blerje apartamenti.

Gjithashtu, konstatohet se subjekti i rivlerësimit më datë 21.09.2005, nëpërmjet “Raiffeisen Bank” ka kaluar drejtpërdrejt në llogarinë bankare të shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., me përshkrimin “*Pagesë për blerje apartamenti*” shumën prej 5,000,000 lekësh.

Në vijim të veprimeve verifikuese-hetimore, me shkresën nr. *** prot., datë 16.03.2018, i jemi drejtuar bankës “Raiffeisen”, me qëllim administrimin e dosjes së plotë të kredisë.

Me shkresën nr. *** prot., datë 26.03.2018, “Raiffeisen Bank” na dërgon dosjen e plotë të kredisë në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Artur H. Malaj.

Nga verifikimi i dokumentacionit të kësaj dosjeje kredie, ndër të tjera konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar **kontratën noteriale të sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 31.05.2005**, të lidhur ndërmjet tij në cilësinë e “porositësit” dhe shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e “sipërmarrësit”, për prenotimin e një apartamenti banimi.

Në nenin 4 të kësaj kontrate parashikohet se **vlera e ambientit të porositur më lart është 61.100 euro** dhe jepet edhe mënyra se si do të bëhej pagesa.

✓ *Sa më sipër, paraprakisht u dyshua se subjekti i rivlerësimit ka pasur një kontratë të fshehtë me shoqërinë sipërmarrëse, për prenotimin e apartamentit të banimit, të cilën nuk e ka deklaruar më parë.*

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këto dy pasuri, nga ana e këtij Komisioni u ngritën dyshime se aktmarrëveshja e lidhur më datë 15.05.2008, midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. është **marrëveshje fiktive**, me qëllim justifikimin e pagesës së çmimit prej 5,000,000 lekësh si pagesë përfundimtare për blerjen e këtij apartamenti dhe gjithashtu për përcaktimin e një çmimi minimal për blerjen e garazhit.

Nga analizimi i dokumentacionit shkresor të pasqyruar si më lart, si edhe nga analiza e të dhënave dhe provave, lidhur me dy pasuritë apartament banimi dhe garazh, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, paraprakisht ky Komision ka konstatuar se:

- ✓ *Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e këtij apartamenti, deklaruar në DPV/2005 dhe në Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar- “Vetting”.*
- ✓ *Subjekti ka paraqitur dokumentacion fiktiv (aktmarrëveshje), me qëllimin përfundimtar të përcaktimit të vlerës së apartamentit dhe të garazhit në vlerën totale prej 5,500,000 lekësh. Në bazë të kësaj aktmarrëveshjeje fiktive, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria e ndërtimit kanë përcaktuar çmimet fiktive të këtyre pasurive edhe në kontratat noteriale të shitblerjes të nënshkruara në vitin 2008.*
- ✓ *Subjekti ka kryer fshehje të pasurisë, duke fshehur vlerën reale të blerjes së apartamentit.*
- ✓ *Nga analiza financiare e kryer konstatohet se subjekti nuk disponon burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesat e kryera për prenotimin e këtij apartamenti. Në rastin më të mirë të shumës prej 15,130 eurosh të likuiduar më datë 31.05.2005, ditën e nënshkrimit të kontratës noteriale. Në rastin më të keq, të shumës prej 30,130 eurosh, duke i shtuar këtu edhe shumë prej 15,000 eurosh që ka pasur detyrim të paguajë më datë 15.07.2005, kjo para disbursimit të kredisë nga “Raiffeisen Bank”.*

Pasi i është kaluar barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, ka dërguar prapësimet e tij pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke ngritur pretendimet e tij lidhur me gjetjet e bëra nga ana e këtij Komisioni për pasuritë apartament dhe garazh, për të cilat ka paraqitur edhe provat përkatëse.

Lidhur me këto përfundime, subjekti i rivlerësimit pretendon se *kontrata e sipërmarrjes, e datës 31.05.2005, është zgjidhur nga vetë palët kontraktuese po në vitin 2005 (22.07.2005), pra është nul, nuk ka prodhuar efekte asnjëherë, si e tillë as nuk është deklaruar prej tij. Madje, pretendon se realisht as nuk e ka disponuar fizikisht në vitin 2006, në kohën e deklarimit të pasurisë.*

Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nuk ka paguar asnjë nga këstet sipas kontratës së datës 31.05.2005, duke qenë se nuk i ishte disbursuar kredia nga banka dhe se, në muajin korrik të vitit 2005, ka pasur mosmarrëveshje me shoqërinë ndërtuese, të cilat janë bërë shkak për zgjidhjen e kontratës së prenotimit.

Gjithashtu, ai sqaron se nuk ka pasur kurrë si qëllim fshehjen e pasurisë, pasi kontrata fillestare e porosisë është bërë para noterit dhe nuk mund të fshihet një akt noterial, por duke qenë se nga palët është bërë nul po në vitin 2005, nuk kishte si të deklaronte një marrëveshje që nuk ekzistonte më. Më tej, subjekti i rivlerësimit sqaron se u ra dakord, nëpërmjet një marrëveshjeje verbale, që do të porosiste po te ky ndërtues një apartament, duke shtuar dhe një garazh të mbyllur, që në total do të kapnin vlerën përafërsisht 55,000 euro, çmim i cili do të ishte i negociueshëm.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se duke qenë se mbas konstatimit të mangësive që kishin apartamenti dhe garazhi, me anë të aktmarrëveshjes së vitit 2008, u përcaktua çmimi përfundimtar i tyre, çmim i cili është i përcaktuar dhe në kontratat noteriale të shitblerjes së këtyre pasurive në vitin 2008.

Për të provuar pretendimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë këtij Komisioni dokumentet si më poshtë:

- Dokument për zgjidhjen e kontratës së prenotimit midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit, i datës 22.07.2005;
- Aktmarrëveshje e vitit 2008;
- Kontratë noteriale të shitjes së apartamentit dhe të garazhit;
- Dokument, kontratë noteriale shitblerjeje me nr. *** rep., nr. **, datë 25.10.2008, (*kontratë e fqinjit të subjektit për të provuar se çmimi i apartamentit të tij është thuajse i njëjtë*);
- Deklaratë noteriale e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k.

Arsyetimi ligjor

Nga provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se, nëpërmjet dokumentit *revokim kontrate*, që mban datën **22.07.2005**, *palët¹ kanë zgjidhur kontratën e porosisë së datës 31.05.2005*, me nr. *** rep., nr. ** kol., me objekt prenotimin e një apartamenti pranë rrugës “****”, Tiranë. Ky dokument është nënshkruar nga z. Artur Malaj, në cilësinë e porositesit dhe administratorit të shoqërisë “****”, z. G.Ç., si përfaqësues i palës investitore.

Në këtë dokument citohet se, mbas nënshkrimit të kontratës së porosisë, porositesi nuk pagoi këstet brenda afateve të përcaktuara në kontratë me pretendimin se nuk i është disbursuar kredia në bankë.

Duke qenë se porositesi nuk i është përgjigjur njoftimit të shoqërisë për të shlyer detyrimet sipas kontratës së porosisë, shoqërisë “****” i ka lindur e drejta të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate.

Në përfundim të këtij akt revokimi, palët kanë rënë dakord që ta konsiderojnë pa efekt dhe të zgjidhur kontratën e porosisë së datës 31.05.2005 dhe se heqin dorë nga çdo pretendim për detyrimet që rrjedhin nga kontrata dhe, njëkohësisht, kanë hequr dorë nga ngritja e ndonjë padie në Gjykatë, që ka lidhje me këtë kontratë.

Bazuar në nenin 659 të Kodit Civil, *kontrata është një veprim juridik me anë të së cilës palët krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.*

Neni 698 i Kodit Civil “Zgjidhja e kontratës” parashikon se: “*Në kontrata me detyrime të ndërsjella, kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër kontraktuese, sipas rastiit, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës, përveç shpërblimit të dëmit.*”

Sa më sipër, Komisioni konstaton se me anë të dokumentit revokim kontrate, të datës 22.07.2005, *palët kanë shprehur vullnetin e tyre për zgjidhjen e kontratës së porosisë me nr. *** rep., nr. ** kol., të datës 31.05.2005*, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pra, kjo

¹ Subjekti i rivlerësimit në cilësinë e porositesit dhe shoqëria “****”, në cilësinë e investitorit.

kontratë është zgjidhur nga palët po në vitin 2005, rrjedhimisht është i bazuar pretendimi i subjektit se kjo kontratë, sa kohë që u zgjidh, u bë nul, nuk prodhoi efekte juridike, atëherë nuk kishte arsye të deklaronte një kontratë inekzistente në kuptimin ligjor.

Lidhur me këtë marrëdhënie, subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe deklaratën noteriale të shtetasit G.Ç.², me nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 16.07.2018, i cili ndër të tjera ka deklaruar se:

*Ka lidhur një kontratë me shtetasin Artur Malaj për prenotimin e një apartamenti që po ndërtohej nga shoqëria e tij në rrugën “****”, Tiranë. Duke qenë se ka kaluar kohë e gjatë, ai deklaron se nuk mban mend shumë detaje, por se i kujtohet se z. Malaj nuk përmbushi detyrimet e kontratës dhe se ajo kontratë u zgjidh, por verbalisht ranë dakord që nëse do t'i jepej kredia dhe do ta kalonte shumën në favorin e tij, do t'i rezervonte një hyrje dhe një garazh me çmim që do të merreshin vesh. Në vijim ai deklaron se, pasi Artur Malaj i kishte bërë pagesën e të gjithë shumës së kredisë që kishte marrë në bankë, patën kontradikta lidhur me dorëzimin e objektit, mosmarrëveshje, të cilat thotë se i kanë zgjidhur kur kanë lidhur kontratën e shitblerjes.*

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë (për të provuar se kontrata e tij për blerjen e apartamentit nuk ka një çmim fiktiv apo të ulët) një kontratë noteriale shitjeje apartamenti, mes shoqërisë “****” dhe fqinjës së tij, nëpërmjet së cilës provon se çmimi për metër katror i shitjes së këtij apartamenti është i përafërt me çmimin që është përcaktuar në kontratën e shitblerjes së apartamentit të tij. Madje, po të kihet parasysh që subjekti e ka marrë apartamentin të papërfunduar (referuar aktmarrëveshjes së vitit 2008 dhe procesverbalit të marrjes në dorëzim të apartamentit), çmimi i blerjes së apartamentit prej tij është edhe më i lartë se i fqinjës së tij. Kështu, çmimi për metër katror që ka paguar fqinji i tij është 52,000 lekë për apartamentin e përfunduar, ndërsa çmimi që ka paguar subjekti i rivlerësimit për apartamentin e papërfunduar (referuar aktmarrëveshjes së vitit 2008, ku rezulton se apartamenti është i papërfunduar dhe pllakat e pashtruara në të gjithë sipërfaqen) është 46,860 lekë për metër katror. Pra, po të kihet parasysh kostoja për përfundimin e apartamentit, kostoja që është përballuar nga vetë subjekti, del se çmimi real që ka paguar subjekti është, në rastin më të mirë, thuajse i njëjtë me atë të fqinjit dhe, në rastin më të keq edhe më i lartë se çmimi i paguar nga fqinji i tij, çka e bën të bazuar dhe të provuar pretendimin e subjektit se çmimi i deklaruar në kontratë është çmimi real.

Referuar kontratave noteriale të nënshkuara mes subjektit “****” dhe subjektit të rivlerësimit, si dhe bashkëshortes së tij, konfirmohet se çmimi i shitblerjes së apartamentit dhe garazhit është i njëjtë me çmimin e parashikuar në **aktmarrëveshjen dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim, të datës 15.05.2008, të nënshkruar mes palëve.**

Neni 660 i Kodit Civil parashikon se *palët në kontratë parashikojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi.*

Ndërsa në nenin 690 të Kodit Civil, parashikohet se *kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme, konstatohet se palët kontraktore gjatë kësaj marrëdhënieje kanë shprehur lirisht vullnetin e tyre në vazhdimësi, nëpërmjet veprimeve konkrete dhe,

² Administrator i shoqërisë “****”.

përfundimisht, me anë të kontratave noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., dhe nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 25.10.2008, kanë formalizuar këtë marrëdhënie, duke përcaktuar dhe çmimet përfundimtare të shitjes së këtyre dy pasurive.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se ekziston një marrëdhënie në vazhdimësi midis subjektit dhe shoqërisë së ndërtimit, e kushtëzuar nga shprehja e vullnetit të të dyja palëve. Që nga momenti i parë i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes mes palëve, në vitin 2005, e deri në lidhjen e kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme në vitin 2008, konstatohet se kemi të bëjmë me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt. Nëpërmjet formave të ndryshme të shprehjes së vullnetit, palët kanë ndryshuar kushtet e marrëveshjes mes tyre. Bazuar në nenin 80 të Kodit Civil, përcaktohet se: *“Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit.”*

Ndërsa neni 83 parashikon se: *“Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm.*

Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji. Në rastet e tjera, veprimi juridik është i vlefshëm, por nuk mund të provohet me dëshmitarë.”

Në këtë rast vlerësohet se deri në momentin e kalimit të pronësisë së apartamentit dhe garazhit, me anë të kontratave noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., dhe nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 25.10.2008, palët e kanë shprehur vullnetin e tyre në të dyja format, me shkrim dhe me gojë. Për aq kohë sa këto veprime nuk janë kundërshtuar nga palët, madje janë konkluduar me veprime konkrete të kalimit të pronësisë, konsiderohet se këto veprime janë të vlefshme.

Në lidhje me pasaktësinë në deklaram, pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar vlerën e apartamentit në vlerë të përcaktuar, por të përafërt, Komisioni vlerëson se kjo ka ardhur nga fakti se kontrata e prenotimit e vitit 2005 u bë nul, pra u zgjidh nga vetë palët, po në vitin 2005, dhe nuk pati mes subjektit dhe shoqërisë ndërtuese marrëveshje të shkruar, por një marrëveshje verbale, të negociueshme, pra me një çmim të përafërt.

Veç kësaj, Komisioni mban parasysh se pika 2 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzojë/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë.

Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor prej ku fillon të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore është pikërisht kjo deklaratë dhe të dhënat që ajo përmban. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të Pasurisë, dhe jo me deklaramet e mëparshme të tij.

Këto deklarime, mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Konkluzioni përfundimtar i Komisionit do të duhet të nxirret nga motivi dhe sjelljet e subjektit, nga mënyra e plotësimit të Deklaratës-Vetting dhe nga të dhënat e hedhura në të. Përdorimi i deklarimeve në vite shërben për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë.

Sikurse e kemi përshkruar më lart, nga ana e Komisionit janë ngritur dyshime lidhur me aktmarrëveshjen e lidhur më datë 15.05.2008, mes subjektit të rivlerësimit dhe administratorit të shoqërisë “****”.

Nisur nga provat e reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, po ashtu edhe nga arsyetimi ligjor i bërë nga ana jonë, Komisioni vlerëson se kjo marrëveshje duket se është nënshkruar në vijim të një marrëdhënieje komplekse mes subjektit të rivlerësimit dhe investitorit dhe se vërtetësia e saj provohet edhe nga deklaratimet e të dyja palëve, si edhe faktit që është konkretizuar nëpërmjet dy kontratave noteriale të shitblerjes.

Nga sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- ❖ *Përputhet deklarimi i subjektit në Deklaratën-Vetting me dokumentacionin e administruar në dosje, si edhe nuk duket të ketë dyshime lidhur me burimin e krijimit të këtyre dy pasurive të paluajtshme.*

5. Makinë tip “Volkswagen”, në bashkëpronësi ½ pjesë ideale me bashkëshorten L. M.

Burimi i krijimit në Deklaratën-Vetting:

Të ardhurat nga paga dhe të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortes si notere.

Ky automjet është deklaruar edhe në DPV/2016, makinë tip “Volkswagen” në bashkëpronësi në pjesë ideale me bashkëshorten L.M., blerë në shumën prej 300,000 lekësh, sipas kontratës noteriale me nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 17.10.2016. Pjesa që zotëron: 50 %.

DPSHTRR-ja, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 29.01.2018, ndër të tjera na përcjell dosjen e mjetit tip “Volkswagen” (“Golf 5”) me targa “****”, mjet i cili është në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij.

Nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti, konstatohet se:

Më datë 15.04.2016, F.B. (*nipi i subjektit të rivlerësimit, djali i motrës*) ka blerë këtë automjet nga subjekti “F.LI.” person fizik me NIPT “****”, për vlerën prej 199,200 lekësh. Ky automjet është shitur nëpërmjet kontratës së shitblerjes të datës 15.04.2016, mbi bazën e së cilës është lëshuar fatura tatimore me nr. *** , datë 15.04.2016.

Nga verifikimi i policës së sigurimit të këtij mjeti, të lidhur me kompaninë “****” sh.a., e cila mban datën e pagesës së primit të sigurimit 18.04.2016, rezulton se subjekti rivlerësimit është shënuar si përdorues i këtij automjeti.

Më datë 17.10.2016, nëpërmjet kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.10.2016, të redaktuar nga notere M.Xh., F.B. ia shet këtë automjet (*automjetin e markës “Volkswagen”, tip “Golf 5”, vit prodhimi 2005*) subjektit të rivlerësimit (*dajës së tij*) dhe bashkëshortes së tij, për vlerën prej 300,000 lekësh.

- ❖ *Komisioni konstaton se subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e tij. Deklarimi përputhet me dokumentacionin e dorëzuar.*
- ❖ *Gjithashtu, Komisioni vlerëson se nuk duket të ketë dyshime mbi këtë pasuri. Subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur të ardhura të mjaftueshme përgjatë vitit 2016, për të justifikuar blerjen e këtij automjeti.*

6. Llogari page, në “Raiffeisen Bank”, më datë 30.01.2017, gjendja e llogarisë 107,850 (njëqind e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë.

Lidhur me këtë llogari, “**Raiffeisen Bank**”, me shkresën nr. *** prot., datë 15.01.2018, dërguar pranë Komisionit, konfirmon këtë llogari page në emër të subjektit të rivlerësimit, me gjendje më datë 30.1.2017, në vlerë 107,850 lekë.

❖ Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

Pasuritë e deklaruara vecmas në Deklaratën-Vetting nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. L.M.

Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në:

- Vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur.
- Burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

7. Llogari në “Raiffeisen Bank” me gjendje më datë 30.01.2017 në vlerë 122,698 euro.

Burimi i krijimit të pasurisë në Deklaratën-Vetting:

Të ardhurat nga puna si notere që në vitin 2005.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Pas verifikimit të kryer nga ana e këtij Komisioni, i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, si edhe nga verifikimi i llogarive bankare të personit të lidhur, konstatohet se gjendja e llogarisë bankare në vlerën prej 122,699 eurosh është krijuar si më poshtë vijon:

- a) Depozituar likuiditete nga personi i lidhur në “Credins Bank”, në vitet 2005, 2006, 2007, 2008. Tërhequr prej “Credins Bank” më datë 28.10.2008 të gjitha këto depozita dhe interesat e krijuara në total në shumën 24,332 euro.

Analizë e likuiditeteve të deklaruara/ depozituara në “Credins Bank”

Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite:

- ✓ Referuar DPV/2005, konstatohet se personi i lidhur nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh në fund të këtij viti, të depozituara në “Credins Bank”.
- ✓ Referuar DPV/2006, personi i lidhur deklaron se ka shtuar pasurinë, duke depozituar në data të ndryshme në “Credins Bank”, në total shumën prej 10,500 eurosh.
- ✓ Referuar DPV/2007, ndër të tjera personi i lidhur deklaron se ka shtuar pasurinë, duke depozituar në “Credins Bank” vlerën prej 12,178 eurosh.

Nisur nga vetëdeklarimi i bërë nga personi i lidhur, rezulton se shuma totale e depozituar deri në fund të vitit 2007 është në vlerën prej 22,678 eurosh (përfshirë dhe interesat e përfituara).

- ✓ Referuar DPV/2008, personi i lidhur ka deklaruar se ka shtuar shumën prej 2,000 eurosh në “Credins Bank”. Gjithashtu, deklaroi se të gjithë shumën që ka pasur te “Credins Bank” e ka tërhequr, nuk e ka harxhuar dhe se e ka gjendje cash.

Nga ana e Komisionit u verifikuan llogaritë bankare në valutë (euro) në “Credins Bank” të personit të lidhur nga ku, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se:

- në fund të vitit 2005, personi i lidhur ka pasur në këtë bankë gjendjen e depozitës (6-mujore) me vlerë 1,500 euro;
- në fund të vitit 2006, personi i lidhur ka pasur në këtë bankë në total gjendjen e depozitës (6-mujore) në vlerën prej 12,109 eurosh;
- në fund të vitit 2007, personi i lidhur ka pasur gjendje një depozitë 3-mujore në vlerën prej 18,455 eurosh, një depozitë 1-mujore në vlerën prej 4,047 eurosh dhe një depozitë 3-mujore në vlerën prej 13 eurosh. Pra, në total, gjendjen e depozitave në vlerën prej 22,875 eurosh.
- në fund të vitit 2008, nuk ka gjendje likuiditetesh në llogarinë euro në “Credins Bank”.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, nga ana e këtij Komisioni paraprakisht është konstatuar se:

- 1) Personi i lidhur, znj. L.M., nuk ka deklaruar në DPV/2005 likuiditetet gjendje në “Credins Bank” në fund të këtij viti, në vlerën prej 1,500 eurosh.
- 2) Nisur nga qarkullimi i deklaruar lidhur me aktivitetin e noterisë për vitin 2006³ dhe fitimit të llogaritur nga ana jonë për këtë vit, na krijohet dyshimi i arsyeshëm lidhur me depozitimimin e shumës prej 3.500 eurosh deri më datë 25.01.2006, të deklaruara si të ardhura nga aktiviteti i noterisë. Vlerësojmë se, referuar qarkullimit të vetëdeklaruar, është pothuajse e pamundur që deri më datë 25.01.2006 ky subjekt tregtar të ketë fituar shumën neto prej 3,500 eurosh apo rreth 433,000 lekë⁴.
- 3) Ka kryer deklarim të pasaktë në DPV/2008, duke deklaruar si shtesë pasurie për këtë vit shumën prej 2,000 eurosh të depozituar në “Credins Bank”.

Lidhur me këto konstatime, mbasi iu kalua barra e provës, subjekti i rivlerësimit ka dërguar prapësimet e tij pranë këtij Komisioni, të shoqëruara me provat përkatëse.

➤ Lidhur me pikën e parë, **subjekti ka dorëzuar si provë:**

- Fletën e gjendjes së llogarisë bankare të “Credins Bank”, me nr. ***, datë 23.11.2005;
- Fotokopje e faqes *** të DPV/2005.

➤ Lidhur me pikën e dytë, **subjekti ka dorëzuar si provë:**

- *Statement*-in bankar të “Tirana Bank”, të vitit 2009, të llogarisë me nr. ***, për lëvizjen e datës 24.08.2009.

➤ Lidhur me pikën e tretë, **subjekti ka dorëzuar si provë:**

- *Statement*-in bankar për vitin 2008 të “Credins Bank”, të llogarisë me nr. ***, datë 03.07.2008;
- *Statement*-in bankar për vitin 2008 të “Credins Bank” të llogarisë me nr. ***, datë 03.07.2008.

³ Vetëdeklaruar qarkullimi në vlerën prej 2.000.000 lekësh, sipas shkresës së organeve tatimore.

⁴ Konvertuar me kursin mesatar të muajit janar 2006 të Bankës së Shqipërisë.

Analiza përfundimtare e kryer nga Komisioni lidhur me këto gjetje

Në shpjegimet e tij lidhur me pikën e parë, subjekti i rivlerësimit konfirmon se më datë 23.11.2005 është çelur depozita në euro në “Credins Bank”, në vlerën prej 1,500 eurosh.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit i referohet DPV/2005⁵, nga ku pretendon se në faqen *** të saj, në rubrikën “*Deklarimi i interesave private, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme*”, ka shënuar çelje depozite në “Credins Bank” me numër llogarie ***, në shumën prej 1.500 eurosh, për të cilën deklaroi se zotëron 50 % të saj.

Në kopjen e deklaratës së DPV/2005, të dërguar nga ILDKPKI-ja pranë këtij Komisioni, nuk konfirmohet ky deklaram. Nga ana tjetër, rezultoi se në kopjen e subjektit të dorëzuar si provë pranë Komisionit për DVP/2005 rezultoi e deklaruar prej tij në faqen ***, pika ***, çelje e depozitës së kursimit në “Credins Bank” në shumën 1,500 euro.

Gjithsesi, duke qenë se kjo shumë ka qenë e depozituar në bankë, *Komisioni vlerëson se nuk ka dyshime se subjekti ka pasur si qëllim mosdeklarimin e saj apo fshehjen, edhe pse referuar kopjes së faqes *** të DVP/2005 të sjellë si provë nga subjekti, rezultoi se ky deklaram është i saktë dhe përputhet edhe me statement-in e “Credins Bank” për llogarinë me numër ***, të sjellë si provë, po nga subjekti.*

Gjithashtu, nga ana e këtij Komisioni është ngritur dyshimi lidhur me depozitimin e shumë prej 3,500 eurosh më datë 25.01.2006, në “Credins Bank” dhe pamundësinë e krijimit të saj nga bashkëshortja e subjektit deri në këtë datë. Edhe lidhur me këtë pikë, subjekti i rivlerësimit konfirmon se bashkëshortja e tij më datë 25.01.2006 ka depozituar në “Credins Bank” shumën prej 3,500 eurosh, por shpjegoi se nuk e ka deklaruar se kjo shumë është si rezultat i fitimit të biznesit vetëm për periudhën 01.01.2006 - 25.01.2006, por fitim edhe i periudhave të mëparshme.

Edhe lidhur me këtë shumë të depozituar, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të qarta që përputhen me provat e sjella prej tij. Konkretisht, ai deklaroi se bashkëshortja e tij ka deklaruar në DPV/2005 shumën prej 450,000 lekësh të disponuara *cash* dhe kjo përputhet me kopjen e faqes *** të DVP/2005 të sjellë si provë nga subjekti dhe shumë prej 100,000 lekësh të depozituar në “Raiffeisen Bank”, për të cilat pretendon se i ka deklaruar me dorëzimin e deklaratës periodike vjetore të vitit 2005, dhe kjo përputhet me kopjen e faqes *** të DVP/2005 të sjellë si provë nga subjekti. Në vijim, subjekti ka sqaruar mënyrën e krijimit dhe depozitimit të shumë prej 3,500 eurosh në “Credins Bank”, e cila ka si burim pikërisht kursimet *cash* prej 450,000 lekësh që përputhet me kopjen e faqes *** të DVP/2005 të sjellë si provë nga subjekti dhe shumë prej 100,000 lekësh, të tërhequr nga “Raiffeisen Bank” më datë 24.01.2006, që përputhet me të dhënat e *statement*-it bankar të “Raiffeisen Bank”. Në kopjen e deklaratës së DPV/2005, të dërguar nga ILDKPKI-ja pranë këtij Komisioni, nuk konfirmohet ky deklaram.

Nga verifikimi i kësaj deklarate periodike/vjetore, nga këqyrja me sy të lirë e një flete të kësaj DPV-je, ku pasqyrohen “*Shtesat dhe pakësimet*”, konstatohet se, në fund të saj, ajo mban

⁵ Një kopje të së cilës e ka dorëzuar pranë këtij Komisioni.

shënimin me shkrim të lirë dore “Datë 05.12.2006”. Nga ana jonë dyshohet se kjo është fletë e shtuar në këtë DPV, nga deklarimi fillestar i subjektit.

Duke qenë se nga Komisioni, edhe në raste të tjera janë konstatuar shtesa fletësh në DPV-të vjetore, si praktikë e kohës e ndjekur nga ILDKPKI-ja gjatë kontrolleve të kryera ndaj subjekteve të saj, mendohet se edhe mund të ketë ndryshim fletësh nga kjo DPV dhe se për këtë arsye nuk gjendet e pasqyruar shuma prej 1,500 eurosh, apo nuk gjenden të pasqyruara shtesat e shumave prej 450,000 lekësh, si gjendje *cash*, dhe shuma prej 100,000 lekësh, e depozituar në “Raiffeisen Bank”.

❖ *Gjithsesi, nga analiza financiare e kryer, nisur nga të ardhurat vjetore të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të shtojë vlerën prej 1,500 eurosh si kursim përgjatë vitit 2005.*

Nisur nga fakti se subjekti tregtar L.M., person fizik, për vitin 2005 ka deklaruar vetëm qarkullimin prej 1,000,000 lekësh, nga ana e Komisionit është përlllogaritur fitimi neto i realizuar për këtë vit bazuar në mesataren e ponderuar mes fitimit dhe qarkullimit për vitet 2008 - 2016⁶, llogaritur në vlerën prej afro 690,000 lekësh.

❖ *Bazuar në këto të dhëna, Komisioni vlerëson se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi që të krijojë shumën prej 450,000 lekësh *cash* dhe 100,000 lekësh në llogarinë e saj në “Raiffeisen” të pretenduara si të deklaruara nga ana e subjektit në vitin 2005⁷.*

❖ *Si rrjedhojë, Komisioni arrin në konkluzionin se personi i lidhur ka burime të ligjshme lidhur me depozitimin e shumës prej 3,500 eurosh më datë 25.01.2006.*

Lidhur me gjetjen e tretë, subjekti pretendon se bashkëshortja e tij më datë 03.07.2008 ka depozituar në “Credins Bank” shumën prej 1,000 eurosh, konfirmuar kjo nga nxjerrja e llogarisë pranë kësaj banke. Gjithashtu, subjekti pretendon se shtesat e interesave të shtuara nga depozita deri më datë 19.10.2008 është në vlerën prej afro 862 eurosh.

Në vijim të arsyetimit të tij, subjekti pretendon se, nisur nga depozitimi i shumës prej 1,000 eurosh dhe marrjes së interesit lidhur me këtë depozitë në shumën prej afro 862 eurosh, ai/personi i lidhur me të ka deklaruar shtesën prej 2,000 eurosh në DPV/2008.

❖ *Komisioni vëren se, me gjithë shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit, sërish kemi të bëjmë me një deklaram të pasaktë, pasi është e vërtetuar se gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2008 është me vlerë zero.*

❖ *Gjithsesi, Komisioni vëren se kjo mospërputhje në deklaram nuk sjell pasoja në këtë proces, pasi nuk cenon ligjshmërinë e burimit të kësaj depozite.*

b) Depozita në euro në “Tirana Bank” krijuar në vitet 2007 - 2008 e deklaruar, fitime nga puna si noter. Tërhequr shuma (*depozita + interesa*) nga “Tirana Bank” më datë 10.4.2010 në vlerë 10.450 euro.

Analizë e likuiditeteve të deklaruara/ depozituara në “Tirana Bank”

⁶ Sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

⁷ Të cilat nuk konfirmohen nga DPV-ja e vitit 2005, e administruar në dosje

Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite:

- ✓ Referuar DPV/2007, konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar si shtesë pasurie vlerën prej 4,000 eurosh të depozituar në “Tirana Bank”, deklaruar si burim krijimi të ardhurat nga puna si notere.
- ✓ Referuar DPV/2008, konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar si shtesë pasurie vlerën prej 6,000 eurosh të depozituar në “Tirana Bank”.
- ✓ Referuar DPV/2009, konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar si shtesë pasurie për këtë vit vlerën prej 2,000 eurosh të depozituar në “Tirana Bank”.
- ✓ Referuar DPV/2010, nuk deklaroi likuiditete të shtuara në këtë bankë dhe as nuk deklaroi se e ka tërhequr shumën prej 10,450 eurosh.

Nga verifikimi dhe këqyrja e llogarisë bankare në euro në “Tirana Bank”, të personit të lidhur, konstatohet se:

- më datë 09.11.2007, L.M. ka depozituar *cash* në llogarinë bankare në “Tirana Bank”, me nr. ***, vlerën prej 4,000 eurosh;
- më datë 12.02.2008, L.M. ka depozituar *cash* në llogarinë bankare në “Tirana Bank” me nr. ***, vlerën prej 6,000 eurosh;
- më datë 16.02.2008 në këtë llogari është krijuar depozita me afat, në total për shumën prej 10,000 eurosh;
- më datë 29.04.2010 është maturuar kjo depozitë, nga ku vlera totale e shlyerjes është prej 10,450 eurosh dhe se gjithashtu rezultoi se është mbyllur si depozitë;
- **më datë 30.04.2010 është tërhequr shuma prej 10,450 eurosh .**

❖ *Në analizë të të dhënave të mësipërme, nga ana e Komisioni paraprakisht është konstatuar se:*

- 1) *Referuar DPV/2009, personi i lidhur ka kryer deklarin të pasaktë lidhur me shtesën e pasurisë për shumën prej 2,000 eurosh, të deklaruar si të depozituar në “Tirana Bank”.*

Lidhur me këtë konstatim, në prapësimet e sjella, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se këtë problem e ka sqaruar në vitin 2011 në ILDKPKI, siç tregohet në procesverbalin e datës 27.07.2011, të mbajtur nga ky institucion.

Në vijim ai shpjegon se, në “Tirana Bank” bashkëshortja e tij kishte në të njëjtën kohë si llogarinë e biznesit si person fizik, ashtu edhe llogarinë e depozitës së kursimeve në euro dhe se ky gabim në deklarin është si rrjedhojë e depozitimit të kësaj shume në llogarinë e biznesit nga ana e bashkëshortes së tij.

Subjekti i rivlerësimit sqaron se më datë 24.08.2009, në llogarinë e “Tirana Bank”, në emër të L.M. është depozituar shuma prej 235,000⁸ lekësh (*kursime nga pagat e tyre*), për të cilën pretendon se në dijeninë e tij ka qenë e depozituar në llogarinë personale të bashkëshortes së tij.

Subjekti ka paraqitur si provë:

- *Statement-in* bankar të “Tirana Bank” të vitit 2009, të llogarisë me nr. ***.

⁸ Vlerë e përafërt me shumën 2,000 euro.

❖ *Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjekti lidhur me këtë deklaram janë bindëse dhe të bazuara në prova.*

c) Në vitin 2008 ka deklaruar të ardhura nga puna si notere në shumën prej 8,000 eurosh, mbahen *cash* në shtëpi.

Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite:

✓ Referuar DPV/2008, ndër të tjera, personi i lidhur ka deklaruar si shtesë pasurie shumën prej 8,000 eurosh gjendje *cash*, jashtë sistemit bankar.

d) Në vitin 2009, deklaruar si të ardhura nga puna si notere shuma prej 30,000 eurosh.

Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite:

✓ Referuar DPV/2009, rezulton se personi i lidhur deklaron si shtesë pasurie shumën prej 30,000 eurosh, të ardhura nga veprimtaria noteriale. Duke qenë se ky subjekt nuk e ka deklaruar si të depozituar në bankë (*këtë vlerë të deklaruar*), si edhe duke qenë se nga verifikimi i llogarive bankare nuk rezulton të jetë depozituar një shumë e tillë, merret e mirëqenë se kjo shumë është mbajtur *cash*, jashtë sistemit bankar.

e) Në vitin 2013, kursime nga fitimet e punës si notere në shumën 10,000 euro, mbahet *cash* në shtëpi.

Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite:

✓ Referuar DPV/2013, konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar kursime (*shtesë pasurie*) nga fitimi i realizuar për vitin 2013, nga aktiviteti i noterisë, shumën prej 10,000 eurosh në gjendje *cash*.

➔ Nga analiza e *cash*-it në valutën euro, të deklaruar nga personi i lidhur konstatohet se, sipas vetëdeklarimit, në total deri në fund të vitit 2013, L.M. ka krijuar gjendjen e *cash*-it si më poshtë:

- 24,332 euro, tërhequr nga “Credins Bank” më datë 28.10.2008;
- 10,450 euro, tërhequr nga “Tirana Bank” më datë 30.04.2010;
- 8,000 euro, deklaruar gjendje *cash* në DPV/2008;
- 30,000 euro, deklaruar në DPV/2009;
- 10,000 euro, deklaruar në DPV/2013.

Totali: 82,782 euro

f) Krijimi i kësaj llogarie bankare në “Raiffeisen Bank” në vitin 2014:

Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite

✓ Referuar DPV/2014, personi i lidhur ka deklaruar se:

- nga e gjithë gjendja *cash* e krijuar (në monedhën euro) për vitet 2005 - 2013, e analizuar si më lart, më datë 27.6.2014 ka depozituar në “Raiffeisen Bank” shumën prej 79,700 eurosh;
- shtesën e pasurisë në shumën prej 11,000 eurosh të kursyera për vitin 2014, nga puna e saj si notere, të cilat i ka depozituar në “Raiffeisen Bank”, më datë 30.12.2014.

Në përfundim ka deklaruar gjendjen e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank” më datë 31.12.2014, në vlerën totale prej 90,704 eurosh, të krijuar nga depozitimi i *cash*-it në

vlerën prej 79,700 eurosh më datë 27.06.2014 dhe depozitimin e shumës prej 11,000 eurosh nga fitimet e aktivitetit të noterisë për vitin 2014.

→ *Nga verifikimi i llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me nr. *** në “Raiffeisen Bank”, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 15.01.2018, konfirmohet se gjendja e kësaj llogarie më datë 31.12.2014 është në vlerën prej 90,703.4 eurosh.*



g) Ecuria e kreditimit të llogarisë në valutë me nr. *** në “Raiffeisen Bank” deri më datë 30.01.2017, paraqitet si më poshtë:

- ✓ Më datë 24.12.2015 depozitohet në “Raiffeisen Bank” shuma prej 10.300 eurosh, të ardhura nga puna si notere për vitin 2015.
- Referuar DPV/2015, konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar shtesën e pasurisë prej 10,309 eurosh të depozituar në “Raiffaisen Bank”.
- Nga verifikimi i llogarisë bankare konstatohet se, më datë 24.12.2015, ky subjekt ka derdhur shumën prej 10,300 eurosh në llogarinë në valutë me nr. ***.
- ✓ Më datë 21.10.2016 depozitohet në “Raiffeisen Bank” shuma prej 15.000 eurosh, pjesë e fitimeve të punës si notere për vitin 2016.
- Referuar DPV/2016, personi i lidhur ka deklaruar shtesën e pasurisë në shumën prej 15,000 eurosh, të depozituar në “Raiffeisen Bank”. Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna si notere.
- Nga verifikimi i llogarisë bankare konstatohet se më datë 21.10.2016 ky subjekt ka derdhur shumën prej 10,300 eurosh në llogarinë në valutë me nr. ***.
- ✓ Më datë 30.12.2016 depozitohet në “Raiffeisen Bank” shuma prej 6,700 eurosh, pjesë e fitimeve nga puna si notere për vitin 2016.
- Referuar DPV/2016, personi i lidhur ka deklaruar shtesën e pasurisë në shumën prej 6,700 eurosh, të depozituar në “Raiffeisen Bank”. Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna si notere.
- Nga verifikimi i llogarisë bankare konstatohet se më datë 30.12.2016 ky subjekt ka derdhur shumën prej 6,700 eurosh në llogarinë në valutë me nr. ***.

→ **Më datë 30.01.2017 kjo depozitë në euro (me nr. ***) është në vlerën 122,698 euro, konfirmuar kjo shumë nga verifikimi i gjendjes së llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”.**

❖ *Nga hetimi në tërësi i kryer nga Komisioni, konstatohet se përputhet deklarimi i subjektit lidhur me gjendjen e kësaj llogarie me dokumentacionin e administruar në dosje.*

8. Depozitë në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT), me nr. * , me gjendje më datë 30.01.2017, në vlerë 44.277 USD.**

Burimi i krijimit të pasurisë në Deklaratën -Vetting:

Të ardhura nga puna si notere.

Këto të ardhura janë deklaruar ndër vite nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, si vijon:

- a) Fillimisht ka depozituar më datë 11.02.2011 në “BKT” shumën prej 30,000 USD, si të ardhura nga puna si notere për vitin 2010.
- b) Më datë 09.05.2012 ka depozituar shumën prej 11.900 USD, si të ardhura nga puna si notere për vitin 2011.

- c) Këto llogari janë bashkuar dhe, së bashku me interesat, gjendja e llogarisë në “BKT” më datë 30.01.2017 është 44.277 USD.

Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite

- ✓ Referuar DPV/2011, konstatohet se personi i lidhur nuk ka deklaruar shtesë pasurie kursimet nga të ardhurat nga puna e saj si notere në shumën prej 30,000 dollarësh.
- ✓ Referuar DPV/2012, konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar se ka hapur depozitën në “BKT” në shumën prej 11,900 dollarësh, por pa deklaruar burimin e krijimit të saj.
- ✓ Nga verifikimi i DPV/2010, konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar shtesën e pasurisë, shumën prej 30,000 dollarësh, të depozituar në “BKT” si të ardhura nga veprimtaria noteriale.

Hetimi i kryer nga Komision

Nga verifikimi i llogarisë bankare të personit të lidhur në “BKT”, konstatohet se:

- Më datë 11.02.2011 personi i lidhur ka depozituar *cash* shumën prej 30,000 USD në llogarinë depozitë në “BKT” me nr. ***, me përshkrimin “Nga aktiviteti noterial viti 2010”.
- Më datë 10.05.2012, personi i lidhur ka depozituar *cash* shumën prej 11,900 USD në llogarinë depozitë në “BKT” me nr. ***, me përshkrimin “Fitime të realizuara gjatë veprimtarisë si notere për vitin 2011”.
- Më datë 27.06.2014, këto dy llogari depozitë janë bashkuar në një të vetme, duke krijuar depozitën me vlerë prej 43,534 eurosh.
- **Gjendja e kësaj llogarie më datë 30.01.2017 konfirmohet se është në vlerën prej 44,277 USD.**

Nisur nga vetëdeklarimi i personit të lidhur në DPV/2010, sipas së cilës ka deklaruar shtesën e pasurisë në shumën prej 30,000 USD në vitin 2010, si të depozituar në “BKT”, nga ana jonë u verifikua llogaria bankare, nga nuk rezulton të jetë depozituar shuma prej 30,000 USD në vitin 2010. Sikurse e kemi sqaruar edhe më lart, konstatohet se shuma prej 30,000 USD është depozituar nga personi i lidhur në “BKT” më datë 11.02.2011.

Për sa më sipër, konstatohet se personi i lidhur ka kryer deklaram të pasaktë, pasi në këtë rast shuma prej 30,000 USD duhej të deklarohet në DPV/2010 si gjendje *cash* jashtë sistemit bankar dhe jo si e depozituar në “BKT”.

❖ *Nga hetimi në tërësi i kryer nga Komisioni konstatohet se përputhet deklarimi i subjektit lidhur me gjendjen e kësaj llogarie, me dokumentacionin e administruar në dosje.*

- 9.** Ka deklaruar **depozitë në dollarë, në “BKT”**. Kjo depozitë është hapur më datë 17.10.2016, me afat 6-mujor. Shuma e kësaj depozite më datë 30.01.2017, në vlerën prej **31,522** (tridhjetë e një mijë e pesëqind e njëzet e dy) dollarësh.

Burimi i krijimit të pasurisë në Deklaratën-Vetting:

Ka deklaruar të ardhurat nga puna si notere.

Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite:

- ✓ Referuar DPV/2016, personi i lidhur ka deklaruar depozitën në dollarë në “BKT” në shumën prej 31,552 dollarësh të çelur më datë 17.10.2016. Burimi i krijimit: të ardhurat nga puna si notere.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga verifikimi i llogarisë bankare të personit të lidhur në “BKT”, konstatohet se nëpërmjet një transferte nga llogaria në llogari, më datë 17.10.2016 tërhiqet si pjesë e fitimit për vitin 2016 në lekë nga llogaria si person fizik notere dhe konvertohet në dollarë, gjithsej 31,522 USD.

- **Konfirmohet shuma prej 31,522 USD nga kontrata e depozitës bankare e datës 17.10.2016, nëpërmjet kopjes së kësaj kontrate të dhënë nga banka dhe të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI, që mban datën 30.01.2017.**

❖ *Lidhur me këtë llogari, Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.*

10. Ka deklaruar llogari kursimi pranë “BKT”-së, e hapur më datë 30.12.2016. Shuma e kësaj llogarie më datë 30.01.2017 në vlerën prej **3,821** (tre mijë e tetëqind e njëzet e një) dollarësh.

Burimi i krijimit të pasurisë në Deklaratën-Vetting:

Të ardhurat nga aktiviteti i noterisë.

Nga verifikimi i llogarisë bankare në “BKT” konstatohet se nëpërmjet një transferte nga llogaria në llogari, më datë 30.12.2016 tërhiqet si pjesë e fitimit për vitin 2016 në lekë nga llogaria si person fizik notere dhe konvertohet në dollarë, gjithsej 3,821 USD.

❖ *Lidhur me këtë llogari, Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.*

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me burimin e krijimit të këtyre llogarive bankare/depozitave në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit

Sikurse e kemi pasqyruar edhe më sipër, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar:

- Llogari bankare në “Raiffeisen Bank” 122,698 euro, konvertuar në lekë me kursin mesatar të muajit janar të vitit 2017 të Bankës së Shqipërisë në vlerën prej 16,312,699 lekësh;
- Depozitë në “BKT” 44,277 USD, konvertuar në lekë me kursin mesatar të muajit janar të vitit 2017 të Bankës së Shqipërisë në vlerën prej 4,919,175 lekësh;
- Depozitë në “BKT” 31,522 USD, konvertuar në lekë me kursin mesatar të muajit janar të vitit 2017 të Bankës së Shqipërisë në vlerën prej 3,502,094 lekësh;
- Llogari kursimi në “BKT” 3,821 USD, konvertuar në lekë me kursin mesatar të muajit janar të vitit 2017 të Bankës së Shqipërisë në vlerën prej 424,513 lekësh.

Pra, personi i lidhur ka deklaruar në total vlerën prej 25,158,481 lekësh, të cilën e zotëron në depozita dhe llogari kursimi, të krijuar nga aktiviteti i noterisë.

QKB-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 23.01.2018, konfirmon se shtetasja L.M., e datëlindjes 19.07.1979, figuron e regjistruar si person fizik me vendimin nr. ***, datë 07.07.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, pajisur me NUIS (NIPT) – “***”.

Nga verifikimi i ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit L.M., person fizik, konstatohet se ky subjekt aktualisht e ushtron aktivitetin në Tiranë, në adresën blv. “****”, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet shkresës me nr. *** prot., datë 29.01.2018, konfirmon se subjekti L.M. aktualisht është tatimpaguese e regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë.

Drejtorja Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën me nr. *** prot., datë 15.02.2018, na dërgon të dhëna lidhur me qarkullimin e realizuar nga subjekti L.M. përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar aktivitet, si edhe të dhënat lidhur me fitimin neto për këto vite.

Referuar përgjigjes së ardhur nga **DRT Tiranë**, ky subjekt nuk shpërndan dividendë pasi, bazuar në nenet 5 dhe 6 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave me nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, subjekti nuk ka detyrimin të depozitave pranë administratës tatimore vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinacionin e fitimit, pasi është biznes i vogël me përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin. Ndërsa, për vitin 2007, DRT Tiranë nuk ka të regjistruar të ardhura, pasi subjektet e biznesit të vogël kanë qenë në administrimin e Bashkisë.

Ndërkohë, nga përgjigja e ardhur nga Bashkia Vlorë⁹ (nën administrimin e së cilës ka qenë ky subjekt në vitin 2007), konfirmohet se qarkullimi i deklaruar nga ana e këtij subjekti për vitin 2007 është në vlerën prej 3,000,000 lekësh.

Nga analiza e bërë më sipër, Komisioni ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit lidhur me gjendjet e këtyre llogarive dhe dokumentacionin e administruar në dosje. Në këtë analizë janë pasqyruar shtesat e likuiditeteve të deklaruara ndër vite nga subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur.

Nga verifikimi i kryer nga ana e këtij Komisioni¹⁰ është konstatuar se vetëdeklarimet e shtesave të likuiditeteve ndër vite të krijuara nga aktiviteti i noterisë, por dhe të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, mundësojnë krijimin e këtyre depozitave/llogarive bankare.

Duke qenë se kryesisht si burim i krijimit të këtyre depozitave/llogarive janë deklaruar të ardhurat nga aktiviteti i noterisë, nga ana e këtij Komisioni u verifikua fitimi neto i realizuar nga ana e subjektit tregtar L.M., person fizik, për vitet 2005 - 2016.

Referuar shkresave të Drejtorisë së Tatimeve dhe Bashkisë Vlorë, për subjektin L.M. nuk është evidentuar fitimi neto pas tatimit për vitet 2005, 2006 dhe 2007, pasi kryesisht për këto vite subjekti ka deklaruar vetëm qarkullimin e realizuar. Për këtë arsye, nga ana jonë është përlllogaritur fitimi neto për këto vite, bazuar në mesataren e ponderuar mes fitimit neto dhe qarkullimit për vitet 2008 - 2016.

Rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, për vitet 2005 - 2016 **ka përfituar si fitim neto nga aktiviteti i saj i noterisë shumën prej afro 36,170,000 lekësh.**

⁹ Administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰ Nga analiza financiare e bërë.

- ❖ *Nisur nga të dhënat dhe faktet e mësipërme, Komisioni vlerëson se të gjitha likuiditetet që zotërohen si pasuri nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimi, të deklaruar në Deklaratën-Vetting në disa depozita dhe llogari kursimi të ndryshme, justifikohen me burime të ligjshme, të ardhurat nga aktiviteti i saj i noterisë.*

II. Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me vilën 3-kateshe, të ndodhur në afërsi të shkollës “Halim Xhelo”, Vlorë

Nga ana e Komisionit u siguruan informacione, të cilat hidhnin dyshime për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, e konkretisht të një shtëpie 3-kateshe dhe truallit mbi të cilën është ndërtuar kjo vilë.

Nga verifikimi i ankesave të depozituara në KLD ndaj gjyqtarit Artur Malaj, të përcjellë pranë këtij Komisioni me shkresën nr. *** prot., datë 14.02.018, konstatohet se në ankesën e bërë nga shtetasi M.XH. (të protokolluar në KLD me nr. *** prot., datë 29.07.2008), për një çështje për të cilën është gjykuar dhe dënuar nga gjykata, ndër të tjera, në këtë ankesë, në një nga paragrafët e saj, citohet shprehimisht: **“Në antitezë me këtë, kryetari i Gjykatës, z. Artur Malaj, ka ndërtuar shtëpinë e tij, në territorin e gjimnazit ‘Halim Xhelo’ dhe me gjyqe të manipuluar e ka legalizuar”.**

Po ashtu, pranë këtij Komisioni është administruar denoncimi nr. *** prot., datë 27.04.2018, i bërë nga shtetasi H.H. i cili, ndër të tjera, krahas denoncimit të një çështjeje konkrete gjyqësore, në letrën e tij denoncuese ka cituar:

“...Artur Malaj ... në oborrin e shkollës ‘Halim Xhelo’ ka bërë vilë 4-katërshe dhe e ka vënë në emër të sekretares së tij. Po kështu, ka dhe apartament te Uji i Ftohtë në emër të nënës.”

Fillimisht u evidentua nga ana jonë vendndodhja e kësaj vile.

Në vijim, me shkresën me nr. *** prot., datë 29.01.20108, i jemi drejtuar ZVRPP-së Vlorë, duke i kërkuar të dhëna lidhur me pasurinë e paluajtshme: godinë 3-kateshe, në rrugicën ndërmjet rrugës “*****” dhe rrugës “*****”, mbrapa shkollës “Halim Xhelo”, Vlorë.

Në administrim të shkresës “Kthim përgjigje” me nr. *** prot., datë 13.02.2018, ZVRPP Vlorë na dërgon të dhëna lidhur me këtë pasuri, ku ndër të tjera konstatohet se:

- Kjo pasuri aktualisht është e regjistruar dhe është në pronësi të shtetasve B.D., A.D. dhe B.D.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Vlorë, rezulton se këto shtetase fillimisht kanë përfituar pronësinë e truallit prej 478 m² dhe ndërtesës mbi këtë truall prej 100 m², nëpërmjet vendimit nr. ***, datë 18.10.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të shtetasit S.D. Nga verifikimi i këtij vendimi, konstatohet se **shtetasi S.D. ka ndërruar jetë më datë 08.01.2007.**

Referuar dokumentacionit të përcjellë nga ZVRPP-ja Vlorë, konstatohet në vitin 2009 ka filluar rikonstruksioni dhe ndërtimi i vilës, sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 24.02.2009, të Bashkisë Vlorë. Rezulton se Bashkia Vlorë ka miratuar destinacionin e sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij, me objekt **“Shtesë anësore e objektit ekzistues dhe ngritje 2 kate + papafingo në lagjen “*****”, Vlorë”**, nga ku sipërfaqja e sheshit të ndërtimit është 478 m² dhe sipërfaqja e ndërtimit është 204.5 m².

Ky objekt është ndërtuar nga shoqëria “*****” sh.p.k. Referuar dokumentacionit të dërguar nga kjo shoqëri pranë këtij Komisioni, konstatohet se më datë 07.04.2008 shtetasi A., B. dhe

B.D. kanë lidhur një kontratë noteriale sipërmarrjeje me shoqërinë “****” sh.p.k., me nr. *** rep., nr. *** kol., për ndërtimin e objektit në fjalë, të redaktuar nga notere L.M.

Sipas situacionit përfundimtar të punimeve, të datës 15.04.2010, të përpiluar nga shoqëria “****” sh.p.k., konstatohet se vlera e këtij objekti të ndërtuar është në shumën prej 13,986,955 lekësh.

Në vijim, nga ana jonë është kërkuar nëpërmjet shkresave të ndryshme drejtuar ZVRPP-së Vlorë informacion lidhur me origjinën e kësaj pasurie.

Nga ana e ZVRPP-së Vlorë na janë kthyer përgjigje jo të plota, apo përgjigjja se referenca ***, e cila është origjina e kësaj prone, nuk ekziston në arkivin e ZVRPP-së Vlorë.

Nisur nga ky fakt, si edhe mbas evidentimit të origjinës së kësaj pasurie të përshkruar në kartelën e pasurisë së përcjellë nga ZVRPP-ja Vlorë pranë këtij Komisioni (*mbas kërkesës së bërë nga ana jonë*), ku në rubrikën “*Përshkrim i veçantë*” pasqyrohej se pasuria *** (*objekt hetimi*) është bashkimi i pasurive ***, vol. ***, fq. *** dhe ***, vol. ***, fq. ***, u paraqitëm në ZVRPP-në Vlorë, me qëllim evidentimin e origjinës së kësaj prone, objekt hetimi.

Mbas verifikimit të bërë nga ana jonë në ZVRPP-në Vlorë, u evidentua origjina e kësaj pasurie, nga ku rezultoi se referencat nr. *** dhe *** janë origjina e kësaj pasurie.

Paraprakisht, evidentohet se referenca nr. ***, e shënuar si origjinë e kësaj pasurie në kartelën e pasurisë, nuk rezultonte në arkivin e ZVRPP-së Vlorë dhe, se nga ana e Komisionit është ngritur dyshimi i arsyeshëm se kjo referencë është shënuar gabim në këtë kartelë pasurie, me qëllim humbjen e gjurmëve të origjinës së saj.

Nga verifikimi i kësaj dosjeje konstatohet se shtetasi S.D. e ka fituar pronësinë e truallit me sipërfaqe prej 414 m² dhe shtëpisë së banimit me sipërfaqe prej 90 m², të ndodhur në rrugën “****”, lagjja “****”, Vlorë, nëpërmjet **vendimit gjyqësor me nr. ***, datë 23.09.2005, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.**

Referuar këtij vendimi, konstatohet se shtetasi S.D. ka fituar pronësinë e objektit të banimit me sipërfaqe 90 m² dhe truallit rreth tij me sipërfaqe prej 414 m², nëpërmjet institutit të parashkrimit fitues.

Gjithashtu, konstatohet se nëpërmjet një **urdhri të brendshëm, që mban datën 13.09.2007**, nga ana e ZVRPP-së Vlorë është urdhëruar të bëhet korigjimi i sipërfaqes në kartelën me nr. ***, nga ku, nëpërmjet korigjimit, sipërfaqja e truallit ka shkuar 478 m², pra 64 m² më shumë se vendimi i Gjykatës, çka është bërë në kundërshtim me ligjin dhe se dyshohet se është pikërisht sipërfaqe që përfshin oborrin e shkollës “Halim Xhelo”.

Nëpërmjet këtyre veprimeve, kjo pasuri ndodhet në gjendje aktuale e regjistruar në ZVRPP, me sipërfaqe trualli prej 478 m² dhe sipërfaqe ndërtimi prej 204.5 m², objekt 3-katësh.

Nisur nga informacionet e marra nga burime të ndryshme, si dhe kërkimet e bëra nga ana e Komisionit për sa i përket origjinës së kësaj prone, pasi u informuam lidhur me vendimin gjyqësor mbi bazën e të cilit është përfutur kjo pasuri, nga ana jonë u kërkuua dosja e plotë gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për të cilin është marrë vendimi nr. ***, datë 23.09.2005.

Nga analiza e përmbledhur e kësaj dosjeje gjyqësore konstatohet se **Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë ka gjykuar padinë e paraqitur më datë 05.09.2005** nga shtetasi S.D. ndaj palës së paditur Bashkia Vlorë, me person të tretë ZVRPP-në Vlorë, me objekt: “*Detyrimin e palës së paditur të njohë pronësinë e paditësit mbi një shtëpi banimi e truall të ndodhur në lagjen*”

“****”, rruqa “****”, Vlorë”, pretenduar e ndërtuar prej tij në vitin 1984 dhe regjistrimin e kësaj pasurie në regjistrat e ZVRPP-së Vlorë.

Ky shtetas ka kërkuar të bëhet pronar i truallit dhe ndërtesës, bazuar në nenin 169 të Kodit Civil, nëpërmjet parashkrimit fitues.

Në vijim, konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, nëpërmjet vendimit nr. ***, datë **23.09.2005**, e ka vendosur detyrimin e të paditurit **Bashkia Vlorë të njohë paditësin pronar** mbi një shtëpi banimi me sipërfaqe 90 m² dhe truallin rreth saj, me sipërfaqe 414 m², të ndodhur në Vlorë, në lagjen “****”, Vlorë.

Rezulton se pala e paditur, Bashkia Vlorë, dhe personi i tretë, ZVRPP-ja Vlorë, nuk janë interesuar për këtë çështje, megjithëse sipas akteve janë njoftuar. Gjykimi është bërë në mungesë të tyre, pasi ato nuk janë paraqitur.

Lidhur me këtë vendim, Avokatura e Shtetit ka kërkuar rivendosjen në afat për të bërë ankimin e saj, ku fillimisht ka evidentuar se nga ana e Gjykatës së Rrethit Vlorë është neglizhuar detyrimi që rrjedh nga neni 79/a i Kodit të Procedurës Civile dhe se gjithashtu ka shprehur qëndrimin e saj se, bazuar në dispozitat e Kodit Civil, pasuritë e shtetit nuk mund të përfitohen me parashkrim fitues dhe, si rrjedhojë, kërkon ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 23.09.2005, të Gjykatës së Rrethit Vlorë, duke e gjykuar çështjen në fakt dhe rrëzimin e padisë.

Fillimisht kjo kërkesë është depozituar në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë, e cila me vendimin nr. ***, datë 22.02.2006, ka vendosur rrëzimin e saj.

Gjithashtu, rezulton se kërkesa e Avokaturës së Shtetit është depozituar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. ***, datë 04.07.2006, ka vendosur në afat ankimin e bërë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë ka ushtruar rekurs shtetasi S.D., i cili ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

Me vendimin nr. ***, datë 10.11.2006, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga shtetasi S.D., duke vërejtur se ky rekurs nuk përmban shkaqe ligjore.

Më tej, konstatohet se nëpërmjet kërkesave të njëpasnjëshme, Avokatura e Shtetit ka kërkuar heqjen dorë nga ankimi civil, me arsyetimin se Avokatura e Shtetit nuk mund të merrte pjesë në konfliktet gjyqësore, kur konflikti ka në gjykim një vlerë nën 5,000,000 lekë të rinj, në bazë të ligjit nr. 8551, datë 18.11.1999, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

Me vendimin nr. ***, datë 16.10.2007, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur se ankimi i paraqitur nga Avokatura e Shtetit kundër vendimit nr. ***, datë 23.09.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nuk do të pranohet për shkak të heqjes dorë.

Ndër të tjera, dyshimet e Komisionit u mbështeten në indicet dhe faktet si më poshtë:

1. Shtetasja A.D. ka bërë deklaram kontradiktor përpara këtij Komisioni, pasi ka deklaruar se:
 - banesa mbi këtë truall është ndërtuar në vitet 1991 - 1992, ndërkohë që babai i saj, në padinë e ngritur, ka pretenduar se kjo banesë është ndërtuar në vitin 1984;
 - ka deklaruar se nuk ka dijeni të plotë për mënyrën se si është përfituar kjo pasuri nga babai i saj, duke pretenduar se e ka përfituar këtë pasuri nga gjyshi, ndërkohë që nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore lidhur me fitimin e kësaj pasurie, konstatohet se kjo shtetase është njoftuar dhe e ka marrë njoftimin për të marrë pjesë në seancat gjyqësore (*por nuk është paraqitur*

në gjyq duke e lënë gjykimin në mungesë) që po zhvilloheshin në Gjykatën e Apelit Vlorë në atë kohë (*pas vdekjes së babait të saj*).

2. Gjithashtu, referuar kësaj dëshmie, rezultoi se kjo shtetase nuk mund të dokumentojë me burime të ligjshme këtë pasuri.
3. Nga burime të ndryshme, nga agjencitë ligjzbatuese, po ashtu edhe nga denoncimet e bëra, janë hedhur dyshime se kjo pasuri është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, se ai dhe familja e tij e kanë ndërtuar atë dhe se kanë banuar aty edhe mbas ndërtimit.
4. Sipas deklaramentit të shtetases A.D., familjarët e subjektit të rivlerësimit kanë jetuar aty me qira, para rikonstruksionit.
5. Vetë subjekti i rivlerësimit, në deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara në ILDKPKI, po ashtu edhe në dosjen e kredisë në “Raiffeisen Bank”, për të cilën ka aplikuar dhe e ka marrë në vitin 2005, ka deklaruar si adresë banimi lagjen “****”, rruga “****”, Vlorë, që përkon me adresën e kësaj vile.
6. Zhvillimi i procesit gjyqësor për përfitimin e kësaj pasurie nga shtetasi S.D., në gjykimin tonë është një proces tërësisht i ndikuar nga shtetasi Artur Malaj, në cilësinë e kryetarit të Gjykatës, duke e njohur në mënyrë të kundërligjshme si pronar të pasurisë në fjalë shtetasin S.D.
7. Kontrata e sipërmarrjes për ndërtimin e vilës është redaktuar nga notere L.M.
8. Hezitimi i ZVRPP-së Vlorë për të na dërguar të dhëna lidhur me origjinën e kësaj pasurie.
9. Manipulimet e ndodhura në ZVRPP-në Vlorë mund të kryheshin vetëm nën ndikimin e subjektit të rivlerësimit.

Pasi i është kaluar barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit 4 të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, ka dërguar prapësimet e tij pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke ngritur pretendimet e tij lidhur me dyshimet e ngritura nga ana e këtij Komisioni për këtë pasuri, për të cilat ka paraqitur edhe provat përkatëse, konkretisht:

- Deklaratën noteriale të znj. B.D. (*bashkëpronar i shtëpisë trekatëshe së bashku me dy vajzat e saj, A. dhe B.D.*), ku ajo deklaron se pronare të shtëpisë janë ajo dhe dy vajzat e saj.
- Certifikatën e vdekjes së babait të subjektit, i cili ka vdekur në nëntor 1993, dhe deri në vdekjen e tij ka banuar në fshatin Llakatund, siç tregon dhe certifikata e vdekjes.
- Ekstraktin nga QKB-ja, ku del se i ndjeri S.D. ka qenë regjistruar si person fizik me NUIS (*numri unik i identifikimit të subjektit*) “***”. Vërtetim nga Dhoma e Avokatisë Vlorë, ku vërtetohet se i ndjeri, S.D., ka qenë avokat pranë kësaj dhome prej muajit korrik të vitit 1992 deri në muajin janar 2007.
- Shkresën nr. *** prot., datë 10.07.2018, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, ku provohet se i ndjeri S.D. ka ushtruar aktivitet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë që prej vitit 1992.
- Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për njohjen pronar të S.D., ku del qartë se pronar i kësaj shtëpie është S.D., jo subjekti dhe as ndonjë nga familjarët e tij.
- Lejen e ndërtimit për shtëpinë trekatëshe, ku del qartë se leja e ndërtimit është lëshuar me kërkesë të familjes D.
- Certifikatën e pronësisë së shtëpisë trekatëshe, ku figuron se kjo shtëpi është në emër të B., A. dhe B. D.
- Deklarata e pronarëve kufitarë, ku deklarojnë se pronar i shtëpisë trekatëshe ka qenë S. D. dhe pas vdekjes së tij prona i ka kaluar bashkëshortes së tij dhe dy vajzave.
- Gjithashtu, si provë u mor në shqyrtim edhe gjithë informacioni i ardhur nga Bashkia Vlorë, ZVRPP-ja Vlorë; dokumentacioni i marrë nga Agjencia e Legalizimit, nga shoqëria ndërtuese e shtëpisë trekatëshe, “****” sh.p.k.

Arsyetim ligjor

Referuar këtyre provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe provave të marra gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, u arrit në përfundimin se nuk provohet fakti se subjekti i rivlerësimit të ketë fshehur pasuri në emër të personave të tjerë, konkretisht të një vile 3-katëshe dhe truallit mbi të cilën është ndërtuar kjo vilë.

Referuar dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. ***, datë 23.09.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton e provuar se, në këtë gjykim paditësi S.D. ka ngritur padi kundër Bashkisë Vlorë me person të tretë ZVRPP-në Vlorë, me objekt: “*Detyrimin e palës së paditur të njohë pronësinë e paditësit mbi një shtëpi banimi e truall të ndodhur në lagjen “*****”, rruga ‘Dëshmorët’, Vlorë*”, duke pretenduar se ka ndërtuar në vitin 1984 një shtëpi banimi njëkatëshe dhe ka kërkuar gjithashtu regjistrimin e kësaj pasurie në regjistrat e ZVRPP-së Vlorë. Ky shtetas ka kërkuar të bëhet pronar i truallit dhe ndërtesës, bazuar në nenin 169 të Kodit Civil, nëpërmjet parashkrimit fitues.

Kjo padi (*referuar dosjes*) është hedhur rregullisht në short elektronik dhe nuk është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, por nga gjyqtarja K.Gj.

Në nenin 169 të Kodit Civil parashikohet se: “*Personi që ka poseduar qetësisht e pa ndërprerje, duke u sjellë sikurse të ishte pronar për njëzete vjet në një pronë të paluajtshme, bëhet pronar i saj.*”

Ndërsa neni 170 i Kodit Civil parashikon se si vepohet kur një person fiton pronën me parashkrim fitues. Kjo dispozitë parashikon se ai që e pretendon këtë gjë, duhet të padisë pronarin e mëparshëm të kësaj pasurie. Pra, sipas teorisë së të drejtës civile për këtë lloj padie, kjo mënyrë fitimi pronësie është origjinale, pra jo e prejardhur. Në çështjen në fjalë kështu është vepruar. Nga paditësi është paditur pronari i mëparshëm i pronës, Bashkia Vlorë.

Në vijim, u konstatua se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, nëpërmjet vendimit nr. ***, **datë 23.09.2005, e ka vendosur detyrimin e të paditurit Bashkia Vlorë të njohë paditësin pronar** mbi një shtëpi banimi me sipërfaqe 90 m² dhe truallin rreth saj me sipërfaqe 414 m², të ndodhur në Vlorë, në lagjen “*****”. Konstatohet se pala e paditur, Bashkia Vlorë, dhe personi i tretë, ZVRPP-ja Vlorë, nuk janë interesuar për këtë çështje, megjithëse sipas akteve janë njoftuar. Gjykimi është bërë në mungesë të tyre, pasi ato nuk janë paraqitur.

Pasi ky vendim ka marrë formë të prerë, prona në fjalë (*trualli*) është çregjistruar nga pronari shtet dhe i ka kaluar pronarit privat, z. S.D. Pavarësisht se Komisioni ka mendimin se kjo pronë nga z. S.D. është fituar në mënyrë të padrejtë, ajo që është objekt i hetimit administrativ nga ky Komision është fakti nëse subjekti i rivlerësimit ka apo jo ndikim apo nëse kjo pronë ka qenë apo është e tij, apo e fshehur në emër të të tjerëve. Nga hetimi ka dalë (*referuar dosjes së vendimit nr. ***, datë 23.09.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*), se as subjekti, as ndonjë nga familjarët e tij nuk ka qenë palë në këtë gjykim, se kjo çështje është hedhur rregullisht në short dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim procedural me këtë çështje, që të provonte përfshirjen, implikimin apo interesimin e tij për këtë pronë. Përkundrazi, si kryetar gjykate e ka shortuar rregullisht këtë çështje në short elektronik, por jo vetëm këtë. Në asnjë nga këto çështje subjekti i rivlerësimit dhe as ndonjë nga familjarët e tij nuk ka qenë as palë e as përfaqësues. Çështja është gjykuar deri në Gjykatë të Lartë (*rivendosja në afat*) dhe

as në gjykatat më të larta subjekti i rivlerësimit apo ndonjë nga familjarët e tij nuk ka qenë as palë dhe as përfaqësues.

Referuar provave të marra në ZVRPP-në Vlorë rezulton se vendimi nr. ***, datë 23.09.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është regjistruar në regjistrat e kësaj zyre, me pronar z. S.D. Pra, që në origjinë prona figuron në emër të z. S.D. dhe nuk ka asnjë të dhënë apo provë se kjo pronë me parë ka qenë në pronësi të subjektit apo familjarëve të tij, nisur edhe nga fakti se në padinë e ngritur sipas nenit 169 të Kodit Civil, si i paditur në gjykim thirret pronari i mëparshëm (neni 170 i Kodit Civil) dhe në çështjen në fjalë është thërritur si e paditur Bashkia Vlorë, si pronare e mëparshme e truallit. Pra, duke filluar që në origjinë prona figuron në emër të z. S.D. dhe jo të subjektit të rivlerësimit apo familjarëve të tij.

Mbas vdekjes së z. S.D. në vitin 2007, referuar provave shkresore të marra nga ZVRPP-ja Vlorë, provohet se kjo pronë ka kaluar në emër të bashkëshortes së tij, znj. B.D. dhe dy vajzave të tij, B. dhe A.D. Edhe në këtë pjesë nuk konstatohet asnjë e dhënë apo provë që të provojë qoftë edhe interesin e subjektit të rivlerësimit për këtë pronë.

Rezulton gjithashtu së në vitin 2009, znj. B.D. dhe dy vajzat e saj, B. dhe A.D., kanë marrë leje ndërtimi për rikonstruksion dhe shtesa për shtëpinë trekatëshe.

Gjatë hetimit u administrua e gjithë praktika e dhënies së lejes së ndërtimit dhe rezulton e provuar se, duke filluar nga kërkesa për leje ndërtimi dhe shesh ndërtimi, projektet që nevojiten për marrjen e lejes (*projekti elektrik, hidraulik, i mbrojtjes nga zjarri etj.*), që të gjithë janë në emër të familjes D., znj. B.D. dhe dy vajzave të saj, B. dhe A.D. Në asnjë nga këto akte nuk konstatohet ndonjë e dhënë për përfshirje apo interesim të subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë pronë.

Mbas përfundimit të rikonstruksionit, pronarët kanë përfituar edhe certifikatën e pronësisë së shtëpisë trikatëshe. Kjo certifikatë pronësie është në emër të familjes D., pra në emër të B., A. dhe B.D., dhe nuk ka asnjë provë apo të dhënë për pronësinë e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë pronë.

Po kështu, referuar provave të marra nga Agjencia e Legalizimit, rezulton se as subjekti i rivlerësimit dhe as ndonjë nga familjarët e tij nuk kanë bërë kërkesë për legalizimin as të kësaj prone dhe as të ndonjë prone tjetër.

Referuar këtyre provave të marra nga ZVRPP-ja Vlorë, nga Bashkia Vlorë, nga Agjencia e Legalizimit, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer fshehje të pasurisë në emër të personave të tjerë. Indicet e cituara nga Komisioni mbi bazën e të cilave ishte krijuar dyshimi u sqaruan nëpërmjet provave të marra gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet provave të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, pasi iu kalua barra e provës, si dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në seancë dëgjimore, shpjegime që përputhen me provat e marra si nga Komisioni, ashtu edhe ato të dorëzuara nga subjekti rivlerësimit.

Konkretisht është pyetur shtetasja A.D. si bashkëpronare e kësaj shtëpie, e cila edhe pse ka disa deklarime kontradiktore lidhur me vitin e ndërtimit të deklaruar prej saj dhe atij të deklaruar nga babai i saj në kohën e ngritjes së padisë, përsëri Komisioni çmon se këto kontradikta nuk prekin thelbin e deklaramit, pra faktin që ajo, motra e saj dhe mamaja e saj dhe askush tjetër janë pronarë të shtëpisë trekatëshe dhe se fakti që për një periudhë kohe (deri në vitin 2008) aty ka banuar me qira familja e vëllait të subjektit të rivlerësimit nuk i bën ata

pronarë të shtëpisë. Deklarimet e shtetases A.D. përputhen me deklaratën e bashkëpronares tjetër, znj. B.D., e cila gjithashtu ka deklaruar se pronare e shtëpisë është ajo dhe dy vajzat e saj.

Këto deklarime Komisioni i vlerëson të vërteta, pasi janë në përputhje edhe me provat e tjera si: vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. ***, datë 23.09.2005, që ka njohur pronar z. S.D., bashkëshorti i znj. B.D. dhe babai i znj. B.D. dhe A.D.; me provat e marra nga ZVRPP-ja Vlorë, ku rezulton se prona që në origjinë ka qenë në emër të z. S.D. dhe se aktualisht figuron në emër të bashkëshortes dhe vajzave të tij; me dokumentacionin për dhënien e lejes dhe sheshit të ndërtimit marrë nga Bashkia Vlorë, etj.

Veç kësaj, nga subjekti i rivlerësimit u paraqitën si provë deklarata noteriale të pronarëve kufitarë të shtëpisë trekatëshe. Në këto deklarata, në ndryshim më atë që thuhej në indicen e sjellë nga agjencia ligjzbatuese, fqinjët (*pronarët kufitarë*) kanë thënë po të njëjtën gjë që thonë edhe dokumentet shkresore, si leja e ndërtimit (*dhe gjithë dokumentacioni shoqërues*), vendimet gjyqësore, certifikata e pronësisë etj., se pronar i shtëpisë ka qenë z. S.D. dhe, me vdekjen e tij, shtëpia i ka kaluar bashkëshortes dhe dy vajzave të tij, dhe se familjarët e subjektit të rivlerësimit (*vëllai dhe mamaja e tij*) në atë shtëpi kanë banuar me qira, deri në kohën kur filloi rikonstrukcioni i shtëpisë në vitin 2008 - 2009.

Fakti që në atë adresë është deklaruar edhe adresa e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të disa viteve radhazi, ka ardhur si pasojë e nevojës së transferimit të gjendjes civile nga fshati në qytet, dhe kjo gjë bëhej thjesht me deklarim para nëpunësit të gjendjes civile dhe jo detyrimisht nga vetë i interesuari, kjo sipas praktikës së kohës, në vitin 1996, siç deklaroi subjekti i rivlerësimit.

Po kështu Komisioni, pas administrimit të të gjitha provave, gjeti të pabazuar indicen e agjencisë ligjzbatuese për ndërtimin e kësaj shtëpie nga babai i subjektit të rivlerësimit, në vitin 1996. Kjo indice, jo vetëm bie në kundërshtim me të gjitha provat e cituara më lart, por bie në kundërshtim edhe me faktin se, referuar certifikatës së vdekjes së babait të subjektit të rivlerësimit, del qartë se ai ka ndërruar jetë që në nëntor 1993, pra disa vite përpara vitit 1996, siç rezulton nga të dhënat e disponuara nga raporti i agjencisë ligjzbatuese.

Lidhur me mundësitë financiare të ndërtimit të kësaj shtëpie, Komisioni konstatoi se: Sipas deklaramit të bërë nga znj. A., kjo shtëpi ka qenë e gjyshit dhe babait të saj kur ishte njëkatëshe dhe më pas është rikonstruktuar (*në formën që ka sot*), jo vetëm nga A.D., por nga dy motrat D. dhe mamaja e tyre, me paratë që ka fituar babai si avokat.

Komisioni gjithashtu konstatoi se, referuar ekstraktit nga QKB-ja, del se i ndjeri S.D. ka qenë regjistruar si person fizik me NUIS “****”. Po kështu, referuar vërtetimit nga Dhoma e Avokatisë Vlorë, vërtetohet se i ndjeri S.D. ka qenë avokat pranë kësaj dhome prej muajit korrik të vitit 1992 deri në muajin janar 2007. Nga shkresa nr. *** prot., datë 10.07.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë, del se i ndjeri S.D. ka ushtruar aktivitetet pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë që prej vitit 1992.

Gjithashtu rezulton se i ndjeri S.D. ka qenë një ish-gjyqtar dhe ish-kryetar gjykate para viteve 1990 dhe deri në vitin 1992. Mbas viteve ‘90 deri në vitin 2007 ka qenë avokat, çfarë, sipas Komisionit, i ka krijuar familjes D.

(*referuar provave te mësipërme*) të ardhura të justifikuar për ndërtimin e shtëpisë trekatëshe.

❖ *Komisioni vëren se në asnjë rast kjo pasuri nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit, me anë të ndonjë dokumenti shkresor apo ndonjë prove tjetër. Nga verifikimi i dokumentacionit të*

*administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Bashkia Vlorë, ZVRPP-ja Vlorë dhe shoqëria “***” sh.p.k., lidhur me këtë pasuri, konstatohet se i gjithë dokumentacioni për fitimin e pronësisë dhe rikonstrukcionin e kësaj vile, është në emër të shtetasit S. D. dhe familjarëve të tij.*

Sa më sipër, nisur nga të dhënat e mësipërme, provat e administruara në dosje, prapësimet e sjella nga ana e subjektit, si edhe provat e reja të dorëzuara nga ana e tij lidhur me këtë pasuri, Komisioni vlerëson se nuk u provua pronësia e fshehtë e subjektit mbi këtë pasuri.

III. Hetimi i kryer nga Komisioni, lidhur me të dhëna nga bankat

Nga hetimi ka rezultuar se:

Nga verifikimi i llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”, llogari në të cilën është disbursuar kredia në favor të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se:

- Më datë 15.04.2009 është kredituar kjo llogari nga shtetasja V.L., në vlerën prej 100,000 lekësh;
- Më datë 13.08.2010 është kredituar kjo llogari nga shtetasja V.L., në vlerën prej 100,000 lekësh;
- Më datë 23.11.2010 është kredituar kjo llogari nga shtetasja V.L., në vlerën prej 100,000 lekësh;
- Më datë 15.03.2012 është kredituar kjo llogari nga shtetasja V.L., në vlerën prej 200,000 lekësh;
- Më datë 24.06.2013 është kredituar kjo llogari nga shtetasja V.L., në vlerën prej 200,000 lekësh;
- Më datë 02.12.2013 është kredituar kjo llogari nga shtetasja V.L., në vlerën prej 300,000 lekësh;

Totali i kreditimeve, në vlerën prej 1,000,000 lekësh.

Nga ana e këtij Komisioni, është pyetur subjekti i rivlerësimit nëse për periudhën 2011 - 2017 është financuar llogaria e tij me vlera më të larta se 500 euro.

Në përgjigjet e sjella pranë këtij Komisioni, protokolluar me nr. *** prot., datë 21.12.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se askush nuk ka financuar llogarinë e tij në një shifër me vlerë më të lartë.

Për sa më sipër, paraprakisht është konstatuar se ky subjekt ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm pranë Komisionit lidhur me kreditimin (financimin) e llogarive bankare të tij, nuk ka deklaruar këto të ardhura të kredituara në llogarinë e tij dhe burimin e krijimit të tyre.

Edhe lidhur me këtë konstatim, pasi i është kaluar barra e provës, subjekti i rivlerësimit ka dërguar prapësimet e tij pranë Komisionit të shoqëruara me dokumentacion provues, duke shpjeguar lidhjen e tij me shtetasen V.L., burimin e shumave të kredituara, si edhe arsyet e kreditimit të kësaj llogarie.

Subjekti ka dorëzuar provat shkresore (dokumentet), si më poshtë:

- Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- Autorizime për znj.V.L., nga z. Artur Malaj, gjithsej 6 (gjatë) copë;
- Deklaratë noteriale e znj.V.L.;
- Lëvizjet e llogarive bankare të “Tirana Bank” dhe “Raiffeisen Bank”.

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, - sikurse është deklaruar prej tij në vitin 2005, - ka lidhur një kontratë kredie bankare me “Raiffeisen Bank”. Në atë kohë e merrte pagën nëpërmjet kësaj banke dhe se në marrëveshje me bankën, pagesa e kredisë bëhej çdo muaj, duke u debituar llogaria e tij rrjedhëse në këtë bankë. Në vitin 2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e prishi kontratën me “Raiffeisen Bank” dhe se pagat do të kalonin nëpërmjet “Tirana Bank”. Për këtë arsye deklaroi se ka autorizuar znj. V.L. (kryetare e Degës së Buxhetit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë)¹¹ që lekët që tërhiqte nga paga e tij në “Tirana Bank”, t’i depozitonte në llogarinë e tij te “Raiffeisen Bank” për llogari të shlyerjes së kredisë.

Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit¹² rezultoi se, në datat që është kredituar llogaria e tij në “Raiffaisen Bank” nga shtetasja V.L., subjekti paraprakisht ka kryer tërheqjen e këtyre shumave nga llogaria e tij e pagës në “Tirana Bank”.

❖ *Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se nuk kemi të bëjmë me financim të llogarive të subjektit, por janë thjesht shuma parash nga paga e tij të tërhequra nga “Tirana Bank” dhe të depozituara nga shtetasja V.L. (e autorizuar nga ana e subjektit) në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”, me qëllim shlyerjen e kësteve të kredisë.*

III. Hetime të kryera nga Komisioni për personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit

Nga ana e Komisionit është kryer hetim pasuror për persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, nga ku deri në këtë fazë të hetimit kemi evidentuar pasuritë si më poshtë:

Personat e tjerë të lidhur, të listuar si më poshtë, janë persona që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

Nga hetimi ka rezultuar se:

1. Pasuritë, E.¹³ dhe A.G.¹⁴

- *Këta dy shtetas kanë qenë garantorë të kredisë së marrë nga ana e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, duke lënë si garanci hipotekore apartamentin në pronësi të tyre, të ndodhur në Vlorë.*

Në mënyrë të përmbledhur pasuria e shtetasve E. dhe A.G., pasqyrohen si më poshtë:

- Pasuri, lloji **apartament**, me nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***, zk. ***, me sip. 86.99 m², blerë më datë 10.12.2015, për çmimin **110,000 euro**, me vendndodhje në **Tiranë** (A.G.);
- Pasuri, lloji **apartament**, me sip. **78.6 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (E.G.);
- Pasuri, lloji **apartament**, me sip. **134.4 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (A.G.);
- Pasuri e llojit **“pyll”**, me sip. **2400 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (A.G.);

¹¹ Konfirmuar me vërtetimin nr. *** prot., datë 06.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

¹² Të administruara në dosje si dhe të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit.

¹³ Motra e subjektit të rivlerësimit.

¹⁴ Bashkëshorti i motrës së subjektit të rivlerësimit.

- Pasuri e llojit “pyll”, me sip. **1600 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (A.G.);
- Pasuri e llojit “pyll”, me sip. **2000 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (A.G.);
- Pasuri e llojit “pyll”, me sip. **5000 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (A.G.);
- Pasuri e llojit “pyll”, me sip. **9000 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (A.G.);
- Pasuri e llojit “pyll”, me sip. **6000 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (A.G.);
- Pasuri e llojit “pyll”, me sip. **15000 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (A.G.);
- Pasuri, lloji **apartament**, me sip. **95.41 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (E.G.);
- Pasuri, lloji **apartament**, me sip. **97 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (A.G.);
- Pasuri e llojit “**Kullotë**”, me sip. **10000 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Zvërnec, Vlorë** (A.G.);
- **Investime në Fondin Prestigj në Raiffeisen Invest**, në vlerën prej **2,875,449 lekësh** (E.G.);
- **Obligacione**, data e investimit 02.12.2016, shuma e investuar **50,000 euro** (A.G.);
- **Bono thesari**, data e investimit 08.10.2010, shuma e investuar **1,550,000 lekë** (A. G.);
- **Bono thesari**, data e investimit 21.11.2011, shuma e investuar **1,400,000 lekë** (A.G.);
- **Depozitë në “BKT”**, shuma e investuar **51,354 USD**, data e investimit të fundit 26.02.2018 (E.G.);
- **Zotërues të 34 % të aksioneve të shoqërisë “****”**, regjistruar në QKB, më datë 02.03.2016, vlera e investuar 3,450,150 lekë ose **25,000 euro** (E.G.);

Hetimi i kryer nga Komisioni u përqendrua dhe në analizën financiare të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur për krijimin e kësaj pasurie, burimin e krijimit të saj, si më poshtë:

Nga ana e Komisionit u bë verifikimi i faqes zyrtare të QKB-së, pas kërkimit në fushat përkatëse me emrat e këtyre dy shtetasve nëse janë administratorë ose ortakë të ndonjë shoqërie tregtare. Rezultoi se vetëm shtetasja E.G., është aksionere në shoqërinë “****”, duke qenë edhe një nga themelueset e kësaj shoqërie, e regjistruar në QKB, më datë 26.02.2016, sikurse e kemi listuar edhe më sipër.

Nga verifikimi i llogarive bankare të këtyre dy shtetasve ndër vite, konstatohen kreditime dhe debitime të shumta llogarish në vlera të konsiderueshme, ndërthurje llogarish, hapje - mbyllje depozitash, investime në bono thesari, obligacione etj., gjendjet e të cilave i kemi paraqitur si më sipër.

Ndër të tjera, u mblodh informacion edhe nga ISSH-së, lidhur me këta dy shtetas, për të cilët na janë dërguar të dhënat e punësimit të tyre prej vitit 2012 e në vazhdim, nga ku rezultoi se:

- Për shtetasin A.G.
- Për periudhën *janar 2012 - shkurt 2016* ka qenë punonjës pranë subjektit “****” sh.p.k., me NIPT “****”, me pagë bruto mujore që varion nga vlera 26,250 deri në 30,000 lekë. Administratori i këtij subjekti tregtar është znj. V.G., ndërsa aksionerët janë znj. V. G. dhe z. A.G., të cilët zotërojnë secili 50 % të kuotave të kapitalit;

- Për periudhën, *tetor 2013 - korrik 2014*, ka qenë punonjës pranë subjektit “*****” sh.a., me NIPT “***”, me pagë bruto mujore që varion nga vlera 44,100 lekë deri në 45,423 lekë;
 - Për periudhën, *korrik 2014 - janar 2015*, ka qenë punonjës pranë subjektit “*****” sh.p.k., me pagë mujore bruto që shkon në vlerën deri në 30,000 lekë;
 - Për periudhën, *shkurt 2016 - korrik 2017*, ka qenë punonjës pranë subjektit “*****” sh.a., me NIPT “***”, me pagë mujore bruto në vlerën prej 60,000 lekësh;
 - Për periudhën *korrik 2017* e në vijim, punonjës pranë shoqërisë “*****” sh.a., me pagë mujore bruto në vlerën prej 60,000 lekësh;
 - Gjithashtu për një periudhë 3-mujore (*prill - qershor 2016*), rezultoi i regjistruar si punonjës pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, me pagë mujore bruto në vlerën prej 75,000 lekësh.
- Për shtetasen E.G.
 - Për periudhën, *janar 2012 - janar 2016*, e regjistruar si e punësuar pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë;
 - Për periudhën *janar 2016* e në vijim, e regjistruar si e punësuar pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Pasi ju kalua barra e provës në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, dhe paragrafit 5 të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, ka dërguar prapësimet e tij pranë Komisionit, me anë të të cilave, subjekti i rivlerësimit mohon të ketë kontribut në krijimin e këtyre pasurive.

➤ *Për të vërtetuar pretendimet tij, subjekti ka paraqitur këto prova të reja:*

- Dokument, certifikatë familjare e A. G.;
- Kopje, librezë pune, e J. G.;
- Kopje, librezë pune, e N. G.;
- Dokument, vërtetime nga ZVRPP-ja Vlorë (4 copë);
- Fotokopje e pasaportës amerikane të J. G e N. G;
- Dokument, aplikim për bashkim familjar mes J. G. dhe A. G.;
- Dokument, vërtetim nga tatimet për J. G.;
- Dokument, fotokopje e vendim regjistrimi si person juridik nr. ***;
- Dokument, fotokopje e vendim të gjykatës së rrethit për regjistrimin si person juridik me nr. ***;
- 2 copë formularë për deklarinim e të ardhurave në SHBA për vitet 2015, 2016;
- Deklaratë noteriale e A. G.;
- 2 ekstrakte të QKB-së, për z. A.B. dhe M. B.;
- Dokument, 2 fotokopje vendimesh për regjistrimin e personit fizik;
- Dokument, vërtetim i gjendjes gjyqësore për shtetasit A. D dhe A. Sh.

Komisioni ka vlerësuar me objektivitet prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit.

Arsyetim ligjor

Në seancën dëgjimore, por edhe në shpjegimet e dhëna në përfundim të fazës hetimore, subjekti i rivlerësimit pretendoi se nuk ka pasur dijeni lidhur me faktin se çfarë pasurish kanë, - duke përjashtuar shtëpinë që e motra dhe kunati kanë vendosur fillimisht si garanci në bankë në vitin 2005, për llogari të kredisë që ai ka marrë në vitin 2005, shtëpinë ku kunati dhe e motra e tij kanë jetuar më parë në Vlorë (*dhe që aktualisht është e shitur*) dhe shtëpinë në Tiranë ku

jetojnë aktualisht sot. Ai deklaron se nuk ka pasur dijeni se çfarë llogarish bankare dispononin ata apo me kë kanë marrëdhënie kontraktore të afërmit e tij, përfshirë dhe ata të lartpërmendur.

Këto deklarime Komisioni i mori në shqyrtim në lidhje të ngushtë me provat e marra gjatë fazës së hetimit administrativ dhe në lidhje edhe me provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës.

Referuar deklaratës noteriale të shtetasit A. G., rezulton se ai pohon se të gjitha pasuritë e përshkruara janë në pronësi të të gjithë familjes së tij (*babait, mamasë, dy vëllezërve të tij dhe të vetë atij*) dhe jo thjesht të tijat. Ai deklaron se pavarësisht që janë shënuar në emër të tij, ato janë pasuri e gjithë familjes. Pasuritë e paluajtshme janë shënuar në emër të tij, pasi gjithë familja ndodhet prej 18 vjetësh në SHBA, ku punon dhe jeton dhe për shkak të largësisë të gjitha veprimet janë kryer prej tij. Subjekti ka shpjeguar se shtetasi A. G. është i moshës 48 vjeç, dhe ka filluar të punojë që në moshën 20 vjeç (*pra 28 vjet punë*). Ka emigruar edhe në Greqi që në vitin 1991, pastaj në Itali në vitin 1994 - 1997, ku ka punuar në të zezë, i pasiguar, si shumë emigrantë të tjerë. Në kthim ka filluar të punojë me babanë e tij, duke u marrë me biznesin e të atit J. G. në fushën e rritjes, tregtimit dhe eksportimit të peshkut dhe molusqeve dhe së fundi kanë krijuar dhe një shoqëri për rritjen e peshkut.

Këto pretendime u gjetën të bazuara nga Komisioni pasi, referuar certifikatës së përbërjes familjare të shtetasit A. G., të sjellë si provë nga subjekti. Rezulton se A. G. figuron në një gjendje familjare me babain, nënën, dy vëllezërit e tij, me bashkëshorten dhe fëmijët. Pra, ata kanë jetuar bashkë në një familje të paktën deri sa u larguan për në SHBA pjesa tjetër e familjes. Për këtë shkak, në vlerësimin e mundësive financiare për pronësitë në emër të A. G., u morën të ardhurat e gjithë familjes së tij.

Sipas pretendimeve të subjektit, babai i A. G., J. G. ka filluar të punojë që në vitin 1978. Në vitin 1987 ai është emëruar Drejtor i Ndërmarrjes së Rritjes dhe Prodhimit të Peshkut në Vlorë, detyrë që e ka vazhduar deri më datë 17.10.1991. Kjo ndërmarrje u privatizua dhe ai është një nga privatizuesit e saj. Nga viti 1991 ai dhe disa kolegë të tij krijuan Kooperativën e Peshkimit Anguillë Narta (vërtetuar me librezën e punës së J. G. por edhe vendimet e gjykatës për regjistrimin si person juridik). Pra provohet se aktiviteti tregtar i familjes ka filluar që në vitin 1991.

Nga viti 1991 deri në vitin 1999 kur është larguar për në SHBA, J. G. dhe familja e tij është marrë me aktivitet tregtar. Rezulton se J. G. është larguar në SHBA fillimisht vetëm dhe më pas ka bërë bashkim familjar me bashkëshorten dhe dy djemtë e tij, ndërsa bashkimi familjar me djalin tjetër (A. G.) dhe familjen e tij është në proces. A. G. për shkak se ishte mbi 21 vjeç dhe i martuar, e pati të pamundur të largohej me prindërit që në atë kohë për shkak të pengesave ligjore të legjislacionit në SHBA dhe sot është në proces të bashkimit familjar me ta (*kjo provohet me dokumentin kthim - përgjigje që autoritetet amerikane i kthejnë vëllait të A. G. që shërben si pikë komunikimi për rrjedhën e procesit*) proces që është drejt përfundimit.

Gjithashtu rezulton se familja e A. G. është marrë gjatë gjithë kohës me biznes. Referuar vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 08.04.1995, për regjistrimin si person juridik të shoqërisë “*** “ sh.p.k., me objekt të aktivitetit të saj rritjes, mbledhjen dhe tregtimin e peshkut, molusqeve dhe prodhimeve të tjera të detit brenda dhe jashtë vendit për eksport dhe import, rezulton se në këtë shoqëri J. G. është ortak.

Po ashtu, referuar vërtetimit nga Dega e Tatimeve Vlorë, vërtetohet se shtetasi J. G. ka qenë i regjistruar pranë kësaj dege (*pra ka ushtruar biznes*) me kod fiskal ***, me vendim të gjykatës nr. ***, datë 19.01.1993, kjo tregon se që në fillim të viteve 1990, i ati i A. G. është marrë me biznes, prodhim, tregtim madje edhe eksport të peshkut drejt Italisë.

Referuar vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 04.11.1999, për regjistrimin si person juridik të shoqërisë “****” sh.p.k., rezulton se z. J. G. (*babai i A. G.*) ka qenë edhe administrator i saj, pra ka ushtruar aktivitet tregtar më shumë se një shoqëri.

Përveç punës dhe të ardhurave në Shqipëri me largimin në SHBA (*rreth afro 18 vjetësh*) konstatohet nga Komisioni se familja e A. G. ka punuar dhe ka krijuar të ardhura. Referuar akteve që tregojnë pagimin e taksave dhe të ardhurat në SHBA nga të dy prindërit e A. G. (*vetëm për dy vjet, pa llogaritur që ata kanë 18 vjet atje*) del se vetëm për vitin 2015 të ardhurat e J. G dhe N. G janë në vlerën 70.170 USD, dhe për vitin 2016 janë në vlerën 66.588 USD. Pra, vetëm në dy vjet të ardhurat (*vetëm të prindërve, pa llogaritur të dy vëllezërve*) janë në vlerën 138.758 USD.

Referuar vërtetimit të ZRPP-së Vlorë rezulton se, në emër të J. G., N. G., R. G. dhe E. G. (*familja e A. G.*) nuk ka asnjë pasuri të regjistruar, çka e bën edhe më bindës deklarin e A.G. se të gjitha pasuritë e familjes (*pra e një familjeje që ka punuar që nga vitet 1970 dhe pas viteve 1990 me biznes dhe sot në punë në SHBA*), i kanë kaluar në emër të familjarit të tyre pikërisht për shkak se janë në SHBA dhe nuk mund të kujdesen dhe të kryejnë veprime juridike për administrimin e tyre.

Subjekti parashton në shpjegimet e tij se paratë, që ata kanë fituar si familje jo vetëm në Shqipëri, por edhe një pjesë të kursimeve në SHBA i kanë investuar në pasuritë e cituara më lart.

Në përfundim të hetimit, për sa u përket pasurive në emër të A. G., Komisioni konstatoi se, gabimisht pasuria e llojit “**Pyll**”, sip. **15.000 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (A.G.), është evidentuar dy herë. Një herë si sip. **15.000 m²** dhe një herë e ndarë në dy sipërfaqe, pasuri e llojit “**Pyll**”, me sip. **9.000 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (A.G.) dhe pasuri e llojit “**Pyll**”, me sip. **6.000 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, me vendndodhje **Vlorë** (A.G.). Por në fakt kjo është vetëm një sip. 15.000 m² e ndarë me pas në dy sip. 9.000 m² dhe 6.000 m². Pra, është marr në shqyrtim dy herë e njëjta sipërfaqe, një herë e bashkuar 15.000 m² dhe një herë e ndarë në dy sipërfaqe.

Si më sipër, Komisioni konstatoi se e gjithë sipërfaqja në pronësi të familjes së A. G., në llojin tokë, është e zërit kadastral, pyll dhe kullotë, vlera e së cilës referuar hartës së vlerës së pronës së caktuar me VKM, në ditën e sotme, për zonën në të cilën ndodhet prona është për pasurinë e llojit kullotë, në vlerën 241 lekë për m², ndërsa për pasurinë e llojit pyll në vlerën 165 lekë për m². Këto vlera janë për vitin 2016, ndërkohë që prona është blerë edhe më herët. Në total, pasuria e familjes së A. G. në llojin pyll është 2.400 + 1.600 + 2.000 + 5.000 + 9.000 + 6.000 X 165 lekë m² = 4.290.000 lekë. Ndërsa pasuria në llojin tokë kullotë është 10.000 m² X 241 lekë për m² = 2.410.000. Pra, në total, shuma e harxhuar për këto pasuri është 6.700.000 lekë, një shumë kjo që justifikohet plotësisht nga aktiviteti tregtar dhe fitimet e realizuara në vite nga kjo veprimtari dhe nga puna në emigracion e A. G. dhe e familjes së tij.

Po kështu, rezulton se apartamenti, me sip. 134.4 m², në zonën kadastrale ***, volumi ***, faqe ***, referencë ***, me vendndodhje në Vlorë (*apartament që ishte vendosur nga kunati i subjektit, si garanci që në vitin 2005 për marrjen e kredisë nga subjekti i rivlerësimit*), është shitur nga kunati i subjektit, në vlerën 60.000 euro. Nga vlera 60.000 euro është likuiduar shuma prej 46 mijë eurosh dhe ky likuidim është bërë me bankë në favor të A. G. dhe jo të subjektit, ndërsa pjesa tjetër nuk është likuiduar ende. Kontrata e shitjes është bërë me kusht që pronësia kalon te blerësi, kur ai të paguajë edhe këstin e fundit.

Si përfundim, Komisioni vlerëson se pasuria në emër të familjes së A. G. është e justifikuar me të ardhurat e realizuara si nga veprimtaria private në disa shoqëri tregtare, ashtu edhe nga veprimtaria në emigracion.

Nuk ka asnjë të dhënë, fakt apo provë që subjekti i rivlerësimit të këtë ndonjë kontribut apo përfitim nga investimet e kumatit të tij dhe të familjes së tij. Nuk ka asnjë provë që të provojë se subjekti i rivlerësimit ka kontribuar në krijimin e tyre.

Megjithëse personat e tjerë të lidhur, për të cilët ky Komision ka kryer hetim pasuror, nuk janë në kushtet e parashikuara në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në cilësinë e huadhënësit, huamarrësit apo dhuruesit, mbi bazën e të cilit kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, -Komisioni vlerëson se shpjegimet dhe provat e paraqitura nga ana e subjektit lidhur me këto pasuri duken bindëse dhe se nuk ka dyshime se subjekti i rivlerësimit të këtë lidhje me këto pasuri.

2. Pasuritë, F.B.¹⁵

Ky shtetas bëhet person tjetër i lidhur sepse:

- *I ka shitur makinën tip “Volkswagen Golf”, për të cilën subjekti rezulton si përdorues në policën e sigurimit para blerjes së saj;*
- *Është punonjës pranë zyrës noteriale të bashkëshortes së tij;*
- *Është identifikuar se ka kryer pagesat për shkollim për vajzat e subjektit;*
- *Ka kryer shërbime të tjera në institucione shtetërore, në emrin e subjektit dhe të bashkëshortes së tij.*

Në mënyrë të përmbledhur pasuritë e shtetasit F.A.B., i datëlindjes 06.12.1988, pasqyrohet si më poshtë:

- Pasuri e llojit “**truall**”, sip. **2015.2 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, në bashkëpronësi, me vendndodhje **Vlorë**;
- Pasuri e llojit “**truall**”, sip. **439.8 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, në bashkëpronësi, me vendndodhje **Vlorë**;
- Pasuri e llojit “**truall**”, sip. **255.8 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, në bashkëpronësi, me vendndodhje **Vlorë**;
- Pasuri e llojit “**truall**”, sip. **1597.6 m²**, në zonën kadastrale ***, vol. ***, fq. ***, referencë ***, në bashkëpronësi, me vendndodhje **Vlorë**;
- **Autoveturë** e markës “**Mercedes-Benz**”, tipi 164 ML 350 4 MATIK, vit prodhimi **2007**.

Nga të dhënat e dërguara nga ISSH-së, konstatohet se ky shtetas është deklaruar për herë të parë si i punësuar pranë zyrës noteriale të bashkëshortes së subjektit, në muajin nëntor 2015 dhe se aktualisht vijon të punojë aty.

Referuar dokumentacionit bankar të administruar në dosje, konstatohet se ky shtetas është i autorizuar të kryejë veprime bankare në emër dhe për llogari të saj, kryesisht në llogaritë e subjektit tregtar dhe se gjithashtu ka kryer disa pagesa në arkë, që kanë të bëjnë me tarifat e shkollimit të fëmijëve të subjektit, por se nuk disponon llogari bankare apo depozita, përveç asaj të pagës.

Nga verifikimi paraprak i dosjeve të pasurive të mësipërme, kryesisht të pasurive të paluajtshme truall, pyje dhe kullota, të regjistruara në emër të motrës, kumatit dhe nipit të

¹⁵ Djali i motrës i subjektit të rivlerësimit.

subjektit, konstatohet se kryesisht janë përfituar nga persona apo janë në bashkëpronësi me shtetas të cilët në vazhdimësi kanë pasur probleme me ligjin, të cilët janë hetuar dhe ndoshta janë dhe me precedent penal, si:

- *Shtetasi A.Sh.*, i dyshuar si personi kryesor i përfshirë në dosjet e tjetërsimit të pronave në Vlorë dhe sipas informacionit që ne disponojmë është i proceduar edhe jashtë vendit për kryerjen e disa veprave penale;
- *Shtetasi A.D.*, me profesion avokat, për të cilin nga informacioni që disponojmë është një nga personat që dyshohet se në vazhdimësi është marrë me mashtrime në fushën financiare, në dijeninë tonë edhe i proceduar penalisht.

Nga hetimi në tërësi i kryer nga ana e Komisionit, paraprakisht konstatohet se personat e tjerë të lidhur, duket se nuk kanë burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë krijuara, të listuara si më lart.

Gjithashtu, nga analizimi i dokumentacionit shkresor të pasqyruar si më lart, si edhe nga analiza e të dhënave dhe provave të administruara në dosje, lidhur me pasuritë e regjistruara në emër të familjarëve të subjektit të rivlerësimit, nga ana e Komisionit **është ngritur dyshimi i arsyeshëm, nga ku duket se me anë të burimeve financiare jo të ligjshme, subjekti i rivlerësimit mund të ketë kontributin kryesor në krijimin/përfitimin e tyre**, - edhe për faktin se këto dyshime mbështeten edhe nga informacionet e dërguara nga agjencitë ligjzbatuese pranë Komisionit.

Pasi iu dërguan rezultatet e hetimit lidhur me pasuritë e personave të tjerë të lidhur, subjekti i rivlerësimit paraqiti prapësimet e tij lidhur me këtë çështje, duke paraqitur edhe prova të reja shkresore, të cilat u morën në shqyrtim nga ana e Komisionit.

Subjekti ka dorëzuar provat shkresore (dokumentet) si më poshtë:

- Ekstrakt i QKB-së, për shtetasin A.B.;
- Vendim për regjistrimin e personit fizik nr. ***;
- Ekstrakt i QKB-së, për shtetasen M.B.;
- Vendim i gjykatës për regjistrimin si person fizik me nr. ***, për znj. M.B.;
- 2(dy) deklarata noteriale, të shtetasve A. dhe M.B.;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore për shtetasit A.D. dhe A.Sh.;
- Certifikatë familjare e shtetasit A.G.;
- Librezë pune e z. J.G.;
- 4 vërtetime nga ZVRPP-së Vlorë;
- Fotokopje e pasaportës amerikane të shtetasve J. dhe N.G.;
- Dokument, fotokopje e aplikimit për bashkim familjar mes z. J.G. dhe z. A.G.;
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë, për z. J.G.;
- Vendim regjistrimi si person juridik me nr. ***;
- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për regjistrimin si person juridik me nr. ***;
- Formulari ***, për deklarimin e të ardhurave në SHBA për vitin 2015;
- Formulari ***, për deklarimin e të ardhurave në SHBA për vitin 2016;
- Deklaratë noteriale e z. A.G.

Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e dërguara pranë Komisionit lidhur me këtë çështje, ndër të tjera ka shpjeguar se:

Së pari, nuk ka pasur dijeni se çfarë pasurish kanë pasur apo kanë apo se me kë kanë hyrë në marrëdhënie kontraktore familjarët e tij.

Së dyti, deklararon se nuk ka asnjë kontribut e as ndonjë përfitim nga këto pasuri.

Së treti, deklararon se lidhur me këto pasuri nuk ka asnjë transaksion nga ana e tij dhe e bashkëshortes së tij.

Gjithsesi, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e sjella pranë Komisionit është munduar të shpjegojë, bazuar në informacionin që i kanë dhënë të afërmit e tij, burimet e krijimit të këtyre pasurive, duke na dërguar të dhëna dhe dokumente lidhur me aftësinë financiare të familjarëve të tij dhe të afërmeve të tyre, që kanë bërë të mundur krijimin e këtyre pasurive.

Lidhur me pasuritë e krijuara nga nipi i tij, shtetasi F.B., subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se si burimi i krijimit të këtyre pasurive kanë shërbyer të ardhurat e biznesit të prindërve të tij, të cilët kanë ushtruar aktivitet tregtar në kohë të ndryshme, secili me aktivitet të regjistruar më vete.

Të gjitha shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit i ka shoqëruar me të dhëna dhe prova të shumta shkresore, të cilat pasi janë shqyrtuar nga Komisioni, janë administruar në dosje.

Referuar deklaratës noteriale të z. F.B. dhe të dy prindërve të tij M. dhe A.B., rezulton se të tre deklaruesit kanë deklaruar se pasuritë listuar me lartë (në një të tretën pjesë) edhe pse janë shënuar në emër të z. F.B. janë pasuri të gjithë familjes së tyre, pasuri e vënë nga puna dhe mandej edhe aktiviteti tregtar i filluar në vitin 2000.

Rezulton se z. F.B. është në një përbërje familjare me prindërit e tij, z. A. dhe znj. M. B., çka e bën të besueshme për Komisionin deklaratën noteriale të tij dhe të prindërve se pasuritë e mësipërme janë në pronësi të gjithë familjes, edhe pse pjesa 1/3-ta që z. F.B. ka në pasuritë e mësipërme figuron vetëm në emër të z. F.B..

Për të provuar se këtë pasuri ata (z. F.B. dhe prindërit e tij) e kanë vënë në mënyrë të ligjshme, nga subjekti i deklaramit u paraqitën si prova:

- Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 29.02.2000, për regjistrimin si person fizik të znj. M.B., me objekt të aktivitetit në fushën e tregtisë së materialeve hidraulike, elektrike. Nga ky vendim provohet se të paktën që në muajin shkurt të vitit 2000 nëna e z. F.B. është marrë me veprimtari tregtare në fushën e tregtimit të mallrave hidraulike, elektrike etj. Pra, provohet që ka ushtruar veprimtari tregtare dhe ka nxjerrë fitime.

E njëjta gjë konfirmohet edhe nga ekstrakti historik i marrë nga QKB-ja, ku vërtetohet se znj. M.B. (nëna e F.) ka qenë e regjistruar si person fizik me numër unik të identifikimit të subjektit, "NUIS" "****".

Po kështu, në vazhdimësi rezulton se familja e z. F.B. është marrë me veprimtari tregtare. Kështu, referuar vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. ***, datë 31.03.2004, për regjistrimin si person fizik të znj. M.B., rezulton se kjo e fundit është regjistruar si person fizik tanimë edhe me objekt të aktivitetit tregtim të artikujve të ndryshëm, industrialë, ushqimorë, konfeksione, kozmetike, mobilieri etj.

E njëjta gjë provohet edhe për z. A.B. (babai i F.B.). Referuar ekstraktit historik të marrë nga QKB-ja provohet se z. A.B. (babai i F.) ka qenë i regjistruar si person fizik me numër unik të identifikimit të subjektit "NUIS" "****".

Kështu, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 06.04.2007, për regjistrimin si person fizik të z. A.B. tregon se ai është regjistruar si person fizik, me objekt të aktivitetit tregtimin e artikujve industrialë të pjesëve të ndryshme hidraulike.

Referuar këtyre provave, Komisioni vlerëson se familja B. ka pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar një të tretën pjesë të pasurive të cituara më lart. Komisionit nuk i rezultoi asnjë provë apo e dhënë se në vënien e këtyre pasurive të ketë pasur ndonjë kontribut nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit as nuk ka blerë, as nuk ka marrë me dhurim ndonjë nga këto prona. Subjekti nuk ka marrë hua, e as ka dhënë hua nipit të tij dhe as provohet se ka ndonjë përfitim nga administrimi i këtyre pronave.

Megjithëse personat e tjerë të lidhur, për të cilët ky Komision ka kryer hetim pasuror, nuk janë në kushtet e parashikuara në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në cilësinë e huadhënësit, huamarrësit apo dhuruesit, mbi bazën e të cilit kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, Komisioni vlerëson se shpjegimet dhe provat e paraqitura nga ana e subjektit lidhur me këto pasuri duken bindëse dhe se nuk ka dyshime se subjekti i rivlerësimit të ketë lidhje me këto pasuri.

◆ **Konkluzioni përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë**

Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se në këtë rast pasaktësitë e konstatuara nuk çmohen se cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Procesi i rivlerësimit, në referim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Artur H. Malaj, me detyrë gjyqtar, ka vijuar mbështetur në administrimin e dokument/raportit të strukturës përgjegjëse për kontrollin e figurës; procedurës për kontrollin e saj; vlerësimit, verifikimit dhe standardeve të kontrollit bazuar në prova, informacione konfidenciale, si dhe informacione e tjera të disponuara nga Grupi i Punës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

Fillimi i procedurës për kontrollin e figurës, bazuar në nenin 35 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, referon për

subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj, fillimisht mbi verifikimin e standardit të plotësimit të deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit, kohës së paraqitjes së deklaratës dhe saktësisë së saj, e cila është dërguar pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

Në referim të shkresës me nr. *** prot., datë 02.11.2017, të DSIK-së, me lëndë “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit të z. Artur Malaj”, dokumenti i klasifikuar, me nivel klasifikimi “*sekret*”, rezulton se formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nga subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj.

Raporti i hartuar pas përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj, është mbështetur në informacione të punuara dhe dërguara pranë kësaj strukture nga organet ligjzbatuese.

Bazuar në informacionet e këtyre institucioneve, Raporti evidenton dhe konstaton **papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur H. Malaj.**

Të dhënat që referohen në këtë Raport për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj, disponojnë informacion që nuk cenon sigurinë e burimit, prej të cilave ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht atë të korrupsionit për shkak të funksionit dhe për implikimin e tij në kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror” (KDZH) pranë DSIK-së, me vendimin nr. ***, datë 13.04.2018, vendosi të deklasifikojë pjesërisht:

- Raportin nr. *** prot., datë 02.11.2017, me lëndë “Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Artur H. Malaj”.

Me shkresën nr. *** prot., datë 23.03.2018, dërguar pranë DSIK-së, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kërkon informacione shtesë në lidhje me raportin e sipërcituar, me qëllim realizimin e një procesi të plotë të hetimit administrativ mbi pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit, **z. Artur H. Malaj.**

Megjithatë Kushtetuta shprehet për kalimin e barrës së provës të subjekti i rivlerësimit, u pa e domosdoshme që Komisioni të dispononte dhe administronte dokumentet që provonin dyshimet e ngritura nga “Raporti i kontrollit të figurës”.

Po ashtu, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, Komisioni duhet të krijojë bindjen e brendshme nëse është apo jo subjekti i rivlerësimit i përfshirë në veprime korruptive apo ka lidhje dhe kontakte të papërshtatshme. Më tej është Komisioni ai që duhet të vlerësojë nëse informacioni që ai disponon si provë mund të përdoret publikisht në një proces administrativ publik apo nëse ai përmban sekret shtetëror dhe duhet kufizuar.

- Nisur nga sa më sipër DSIK-ja, me shkresë nr. *** prot., datë 11.05.2018, dërgon Raportin e përditësuar duke integruar dhe informacionet e ardhura pas afatit ligjor të përfundimit të

procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj, raport ky i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 11.05.2018.

Në raportin e ripunuar jepen detaje në lidhje me informacionin e dërguar nga autoritetet verifikuese, në kohështrirje para dhe gjatë periudhës së rivlerësimit për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, konkretisht atë të korrupsionit pasiv të këtij subjekti, si më poshtë.

1. Gjatë periudhës në të cilën z. Artur Malaj ushtronte detyrën si kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dyshohet se ka ulur dënimin nga burg me gjobë për shtetasin XXX kundrejt një mite, dhënë nga i akuzuari. Çështja është gjykuar nga z. Artur Malaj pa short.
2. Z. Artur Malaj në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dyshohet për bashkëpunim në përfitime të paligjshme me znj. K.Gj., gjyqtare pranë kësaj gjykate. Gjyqtarja në fjalë ka marrë pa short çështjen civile, nr. ***, datë 17.07.1997, dhe dyshohet që ka zvarritur gjykimin qëllimisht për përfitime.
3. Gjyqtarja K.Gj. në dhënien e vendimit civil me nr. ***, datë 23.09.2005, në bashkëpunim dhe në interes të kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, z. Artur Malaj, jep në pronësi me parashkrim fitues një pronë publike në qytetin e Vlorës. Sipas informacioneve rezulton se shtëpia, objekt i vendimit civil gjyqësor, është ndërtuar pa leje në vitet 1995-1996 nga babai i Artur Malajt. Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka përdorur pozitën e tij me qëllim përfitimin e një prone (*truall, pronë shtetërore*) në qytetin e Vlorës.
4. Pas verifikimeve të kryera në vazhdimësi nga institucionet verifikuese rezulton gjithashtu se shumata monetare që z. Artur Malaj kërkonte për favoret gjyqësore, të dorëzoheshin disa ditë përpara se të jepeshin vendimet përfundimtare gjyqësore, me qëllim favorizimin e tyre. *Shumat e përfituara nga aktivitetet e paligjshme janë investuar në fushën e ndërtimit në emër të personave të tretë.*

Në raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin në fjalë, *DSIK-ja vlerëson se gjendemi në një situatë që evidenton forma të shfaqjes së korrupsionit sistematik pasiv në sistemin e drejtësisë, ku në rastin në fjalë përfshihen në veprime korruptive dy gjyqtarë në bashkëpunim me njëri - tjetrin dhe me persona të tretë, në shkelje të detyrës. Kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, ku përfshihen “krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni.”*

Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj, për veprimtari korruptive, *evidentojnë rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston kontakt i papërshtatshëm, sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në formën e takimit të qëllimshëm, në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.*

Në raport citohet se, në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës së një subjekti rivlerësimi, në rastin tonë kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mospërbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për atë vetë si funksionar publik, apo për persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit dhe të palëve, *vlerësohet se cenohet pastërtia e figurës së subjektit në fjalë dhe shkalla e besueshmërisë së tij.*

Në përfundim, Grupi i Punës, bazuar në germën “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016 ka konkluduar duke e vlerësuar si individ të mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale. Nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, DSIK-ja konfirmon

*konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, **për papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.***

Pasi i është kaluar barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5, të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, ka dërguar prapësimet e tij pranë Komisionit, duke ngritur pretendimet e tij lidhur me konstatimet e bëra nga Grupi i Punës së DSIK-së, për të cilat ka paraqitur edhe provat përkatëse.

Subjekti ka dorëzuar provat shkresore (dokumentet), si më poshtë:

- Kërkesë drejtuar DSIK-së;
- Shkresë kthim përgjigje, nr. ***, datë 19.07.2018;
- **Fotokopje, kapaku i kapitullit çështja, Kokoshi, etj..**
- Mandatarkëtim;
- Biletë shorti;
- **Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. ***, datë 03.02.2005;**
- Vendim i KLD-së, datë 11.10.2003;
- Vendim i KLD-së, datë 20.05.2004;
- **Kapak i fashikullit të vendimit nr. ***;**
- Biletë shorti;
- Kërkesë padi;
- Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. ***;
- Certifikatë vdekjeje e z. H.M.;
- **Kapak i fashikullit dhe vendimi nr. ***;**
- Biletë shorti;
- Kërkesë e zyrës së Avokaturës së Shtetit;
- **Kapak i fashikullit për çështjen, V.P., D.L.;**
- Biletë shorti;
- Fotokopje e librit të shortit;
- Kërkesë e gjyqtarit të çështjes z. S.K., për plotësimin e trupit gjykues;
- Vendim nr. ***, datë 22.12.2004;
- Vendim i Gjykatës së Apelit Vlorë, nr. ***, datë 21.10.2005;
- **Kapak i fashikullit i çështjes për A.V. dhe A.S.;**
- Biletë shorti;
- Fotokopje e librit të shortit ;
- Kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit;
- Konkluzionet e prokurores;
- **Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. ***, datë 26.10.2005;**
- Apel kundërshtues i prokurores;
- Vendim i Gjykatës së Apelit Vlorë, nr. ***, datë 20.09.2006;
- Vendim i Gjykatës së Lartë, nr. ***, datë 24.09.2008.

Në vijim të procesit të verifikimit të figurës, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe garantimin e të drejtave të subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni mund të kryejë hetim të thelluar.

Mënyra e kontrollit të figurës detajohet brenda parimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016 që, në nenin 34 të tij përcakton qartë objektin e kontrollit të figurës: “*Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në*

krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës”.

Duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, duhet të jetë gjithnjë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit kërkohet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij.

Raporti i Grupit të Punës së DSIK-së (*informacioni që përmbante*) iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e rrethanave që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanave lehtësuese, të rrjedhura nga informacioni që kishte marrë Grupi i Punës dhe kishin çuar në konstatimin e *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*, si dhe vërtetësisë së ngjarjeve konkrete, me qëllim gjetjen e provave, për realizimin e një procesi të rregullt ligjor.

Nga evidentimet e bëra në Raportin mbi pastërtinë e figurës, trupi gjykues ka bërë një hetim të thelluar administrativ në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës. Për të krijuar bindjen, Komisioni i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për të marrë dosjet gjyqësore të cituara si raste korruptive në raportin e DSIK-së dhe ka bërë një analizë të plotë profesionale (*interpretim/opinion ligjor*) të tyre, si më poshtë vijon:

1. Dosja gjyqësore me të pandehur shtetasin A.S.

Nga informacione të dërguara nga organet verifikuese pranë këtij Komisioni, hidhen dyshime se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, është i përfshirë në veprime korruptive, e konkretisht duke marrë mitë nëpërmjet personave të tretë me premtimin për favorizime në procesin penal gjyqësor që po zhvillohej në vitin 2005, e konkretisht për procesin që po zhvillohej ndaj shtetasit A.S., në ato kohë i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Heqja e paligjshme e lirisë”, parashikuar nga neni 110 i Kodit Penal.

Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 06.06.2018, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me qëllim administrimin e dosjes së plotë gjyqësore për të cilën kjo gjykatë ka dhënë vendimin për shtetasin A.S.

Në administrim të kësaj dosjeje gjyqësore, konstatohet se:

Përshkrimi i procesit gjyqësor:

1. Më datë 01.04.2005, **Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë** ka dërguar kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, i vitit 2004, duke dërguar për gjykim: *Të pandehurin: A.V.*, akuzuar për *veprën penale të kryerjes së marrëdhënies seksuale me dhunë me të mitur*, të moshës 14 -18 vjeç, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 101/2 i Kodit Penal.

Të pandehurin: A.S., akuzuar për *veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë*, të parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal.

Të pandehurin: E.M., akuzuar për *veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë*, të parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal.

2. Pas hedhjes së shortit në **Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë**, konstatohet se kjo dosje i ka rënë për shqyrtim gjyqtarit Artur Malaj, njëkohësisht dhe kryetari i gjykatës në atë kohë.

Lidhur me këtë çështje, trupi gjykues i përbërë:

Artur Malaj	Kryesues
K.Gj.	Anëtare
H.Ç.	Anëtare

ka marrë **vendimin nr. *****, datë **26.10.2005**, sipas të cilit ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit A.V. për veprën penale të marrëdhënies seksuale me dhunë me të mitura të moshës 14 -18 vjeç të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 101/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 13 vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit A.S. për veprën penale të përkrahjes së autorit të krimit të parashikuar nga neni 302/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 muaj burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit E.M. për veprën penale të moskallëzimit të krimit të parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 200,000 lekë gjobë.

Nga verifikimi i kësaj dosjeje gjyqësore dhe këtij vendimi konstatohet se, ndër të tjera, prokurori i çështjes ka kërkuar deklarin fajtor të të pandehurit A.S. për veprën penale të heqjes së paligjshme të lirisë, të parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim.

Konstatohet se gjykata, bazuar në nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale, ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale për të pandehurin A.S., duke e dënuar me 20 muaj burg për përkrahje të autoreve, konkluzion të cilin e ka arsyetuar në vendimin e saj.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin e saj nr. *, datë **20.09.2006**, me:**

Të pandehur: A.V.

Akuzuar: Për veprën penale të “Marrëdhënies seksuale me dhunë, me të mitura, në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 101/2 i Kodit Penal.

Të pandehur: A.S. dhe E.M.

Akuzuar: Për veprën penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë të kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal.

ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. ****, datë **26.10.2005** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për sa i përket të pandehurve A.S. dhe E.M.;
- *Prishjen e vendimit të mësipërm për të pandehurin A.V.*

4. Gjykata e Lartë me vendimin e saj nr. *, datë **24.09.2008**, me:**

Të gjykuar: 1. A.V.

Akuzuar: Për veprën penale të “Marrëdhënies seksuale me dhunë, me të mitura, në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 101/2 i Kodit Penal.

2. A.S.

3. E.M.

Akuzuar: Për veprën penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë të kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 110/2 i Kodit Penal.

ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. ****, datë **20.09.2006**, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Në përfundim të analizës së dosjes gjyqësore, arrijmë në përfundimin se nuk rezulton i saktë informacioni i ardhur nga institucionet verifikuese i cituar në “Raportin e pastërtisë së figurës” për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj.

2. Dosja gjyqësore lidhur me një çështje të gjykuar nga gjyqtarja K.Gj.

Gjithashtu, nga informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese, hidhen dyshime lidhur me një dosje të gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë për çështje pronësie, të gjykuar nga gjyqtarja K.Gj., mbi bazën e të cilës është marrë vendimi nr. ***, datë 03.02.2005.

Sipas këtyre informacioneve, kryetari i gjykatës z. Artur Malaj ka manipuluar shortin duke ia caktuar dosjen gjyqtares K.Gj., të cilësuar si person të afërt me të dhe se ka ndikuar në marrjen e vendimit përfundimtar lidhur me këtë çështje.

Komisioni , me shkresën nr. *** prot., datë 03.05.2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me qëllim administrimin e dosjes së plotë gjyqësore për të cilën kjo gjykatë ka dhënë vendimin nr. ***, datë 03.02.2005.

Në administrim të kësaj dosjeje gjyqësore, konstatohet se:

Përshkrimi i procesit gjyqësor:

Trupi gjykues i përbërë nga:

K.Gj. -gjyqtare,

Me vendimin e saj nr. ***, datë 03.02.2005, me palë :

Paditës: E.K.,...etj.

I paditur: Xh.S., M.M.

Personi i tretë: Shoqëria “****”, me administrator z. L.Ll., e përfaqësuar nga av. E. V.

Objekti: Goditje për falsitet i vendimit nr. ***, datë 17.07.1997, të K.K.K të Pronave Vlorë. Pavlefshmëri e kontratës së shitjes, nr. *** rep, datë 22.11.2000. Detyrim i ZVRPP-së Vlorë për çregjistrim nga regjistrat hipotekor. Marrja e masës së përkohshme për sigurimin e padisë.

Baza ligjore: Nenet 270,220/a, 205/b, 31 e vijues dhe 153 të Kodit të Procedurës Civile,

ka vendosur:

- ***Pushimin e gjykimit të çështjes civile nr. ***.***

Nga verifikimi i kësaj dosjeje gjyqësore konstatohet se, në seancën e datës 03.02.2005 paditësit kanë kërkuar pezullimin e gjykimit, kërkesë e cila nuk është pranuar nga gjykata dhe se po në këtë seancë kanë kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes civile.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 201 të Kodit të Procedurës Penale, duke qenë se është në disponimin e paditësve vazhdimi i gjykimit ose jo dhe se ata kanë të drejtë të pushojnë gjykimin në çdo fazë, gjykata ka çmuar se gjykimi i kësaj çështjeje duhet të pushohet.

*Në këtë dosje, konstatohet edhe një biletë shorti me nr. ***, e datës 09.10.2013, e cila ka mbishkrimin me shkrim të lirë dore “Klodi”. Gjithashtu, në kërkesëpadinë e administruar në dosje, me nr. ***, datë 29.09.2003, konstatohet siglimi me shkrim të lirë dore që mban datën 09.10.2003, në emër të znj. K.*

Komisioni vlerëson se, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kjo indice nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova *në lidhje me kriteret e rivlerësimit në aspektin profesional* për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj.

Gjithashtu, nga analiza e kësaj dosjeje gjyqësore, arrijmë në përfundimin se nuk rezulton i saktë e i bazuar në prova dhe fakte informacioni i ardhur nga institucionet verifikuese, i cituar në “Raportin e pastërtisë së figurës”, për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj.

3. Dosja gjyqësore lidhur me fitimin e pronësisë së truallit dhe banesës pranë shkollës “Halim Xhelo”.

Sikurse e kemi trajtuar dhe në relacionin e vlerësimit pasuror të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj, nga institucionet verifikuese, por edhe nga denoncime të tjera hidhen dyshime lidhur me një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, nga ku sipas agjencive ligjzbatuese është përfituar nëpërmjet një procesi gjyqësor të manipuluar.

Nisur nga informacionet e marra nga “Raporti i pastërtisë së figurës”, njëkohësisht me kërkimet e bëra nga ana jonë lidhur me origjinën e kësaj prone, pasi u informuam lidhur me vendimin gjyqësor mbi bazën e të cilit është përfituar kjo pasuri, nga ana jonë u kërkua dosja e plotë gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të cilin është marrë vendimi nr. ***, datë 23.09.2005.

Nga analiza e përmbledhur e kësaj dosjeje gjyqësore, konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka gjykuar padinë e paraqitur më datë 05.09.2005 nga shtetasi S.D. ndaj palës së paditur Bashkia Vlorë me person të tretë ZVRPP-në Vlorë, me objekt: “*Detyrimin e palës së paditur të njohë pronësinë e paditësit mbi një shtëpi banimi e truall të ndodhur në lagjen “****”, Rr. “****”, Vlorë*”, pretenduar e ndërtuar prej tij në vitin 1984 dhe regjistrimin e kësaj pasurie në regjistrat e ZVRPP-së Vlorë.

Kjo dosje gjyqësore është marrë në analizë nga ana e këtij Komisioni në pjesën e vlerësimit të pasurisë dhe u konstatua se çështja është gjykuar nga gjyqtarja K. Gj., është hedhur me short dhe është regjistruar në regjistrin elektronik dhe librin e shortit. Gjithashtu është konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe asnjë nga familjarët e tij nuk kanë qenë palë apo përfaqësues në procesin gjyqësor për përfitimin e pronësisë së kësaj banese dhe truallit mbi të cilin ajo është ndërtuar.

Gjithashtu, nga analiza e kësaj dosjeje gjyqësore, arrijmë në përfundimin se nuk rezulton i saktë e i bazuar në prova dhe fakte informacioni i ardhur nga institucionet verifikuese, i cituar në “Raportin e pastërtisë së figurës” për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj.

Nga hetimi në tërësi lidhur me raportin e DSIK-së, Komisioni konstatoi se informacioni i përcjellë nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016 dhe ai konsiderohet i paplotë. Informacioni në çdo rast duhet të jetë i bazuar mbi prova të sakta, kjo është edhe fryma e ligjit për krijimin e Grupit të Punës. Nëse Grupi i Punës nuk do të bëjë një verifikim të plotë, atëherë ai rrezikon të nxjerrë përfundime të gabuara dhe të rëndojë pozitën e subjekteve të rivlerësimit. Në këtë rast, Grupi i Punës nuk ka kryer verifikime të mëtejshme, duke arritur në konkluzion vetëm mbi bazën e informacionit të paverifikuar.

Në këto kushte, duke analizuar raportin e ardhur nga DSIK-ja dhe organet ligjzbatuese, duke bërë një studim të thelluar të tyre, duke administruar provat e tjera në lidhje me çështjen, Komisioni çmon se informacioni mbi të cilin ka ardhur rekomandimi i DSIK-së **rezulton i**

pasaktë dhe i pabazuar në prova dhe fakte, për pasojë subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, konsiderohet i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

I. Raporti i mbajtur nga KLD-ja për analizimin e aftësisë profesionale

Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

1. Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, më datë 25.01.2017 ka paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, aktet e mëposhtme:

- 1) Formulari i vetëdeklarimit, gjithsej 6 fletë;
- 2) 20 dokumente shoqëruese të formularit të vetëdeklarimit, gjithsej 107 fletë. Lista e inventarit të akteve është pjesë e dosjes së rivlerësimit.

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet si më poshtë:

- a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit.

Në rubrikën “C”, - të dhëna për vetëvlerësimin profesional, - subjekti nuk ka të plotësuar vetëm pikën 6 të kësaj rubrike. Pjesët e tjera paraqiten të plota dhe sipas shtojcës që përcakton ligji. Formulari nuk ka kundërthënie, nuk ka mangësi dhe është i nënshkruar rregullisht. Ai ka deklaruar si periudhë të rivlerësimit 3 vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016.

- b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit.

Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëvlerësimit, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, në periudhën 20.05.2004 - 04.11.2013 ka qenë gjyqtar (kryetar) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga data 04.11.2013 ka kaluar në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit, ku vijon edhe aktualisht detyrën.

2. Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së.

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtar Artur Malaj ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, më datë 27.02.1999, dhe titullin

“Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2002. Pas studimeve, më datë 21.10.2002, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tepelenë dhe më datë 11.10.2003, është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Më pas, më datë 20.05.2004 është emëruar kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në vijim, më datë 04.11.2013, gjyqtari Artur Malaj është emëruar gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, ku vazhdon dhe aktualisht. Prej 2016, ai është caktuar me short anëtar i Kolegjit Zgjedhor sipas nenit 146 të Kodit Zgjedhor.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, *rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për gjyqtarin Artur Malaj janë paraqitur gjithsej 10 ankesa në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (asnjë ankesë për vitin 2013, 6 ankesa në vitin 2014, 2 ankesa në vitin 2015 dhe 2 ankesa në vitin 2016).*

5 ankesa (3 ankesa të vitit 2014 dhe 2 ankesa të vitit 2015) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

1 ankesë e vitit 2014 i është dërguar për kompetencë Ministrisë së Drejtësisë pasi është jashtë kompetencës së KLD-së.

4 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet e tyre janë si vijojnë:

- i. 1 ankesë e vitit 2014 verifikuar bazuar mbi informacionin e dërguar nga vetë kryetari për vendimet e cenuara i është regjistruar gjyqtarit për vlerësim profesional dhe etik;
- ii. 2 ankesa (1 ankesë e vitit 2014 dhe një ankesë e vitit 2016) verifikuar bazuar mbi informacionin e dërguar nga vetë kryetari për mosdorëzimin në afat të vendimeve të arsyetuara është arkivuar pasi pretendimi ishte i pabazuar;
- iii. 1 ankesë e vitit 2016 është në proces verifikimi në pritje të relacionit përfundimtar.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Artur Malaj, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLD. Në funksion të qartësisë së analizës së gjetjeve, 3 vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti referohen sipas radhës së paraqitur në Pjesën I të këtij raporti, me termat “dokumenti 1, dokumenti 2 dhe dokumenti 3”. Ndërsa 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, referohen sipas radhës së paraqitur në Pjesën II të këtij raporti, me termat “dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 4 dhe dosja 5”.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Respekton rregullat e

drejtshkrimi, në funksion të qartësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor, ndonëse nuk përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe (*shih dokumentet nr. 1, 2 dhe 3, si dhe dosjet nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5*).

Struktura e vendimeve përfundimtare përgjithësisht është e standardizuar dhe respekton kërkesat e legjislacionit procedural. Në tekstet e vendimeve, ai përdor pjesë arsytimi të standardizuara mbi kompetencën e gjykatës, edhe nëse nga palët nuk ka pasur kundërshtime të saj.

Struktura e vendimeve është e qëndrueshme dhe e mirorganizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Në 6 raste, pjesa arsytuese është e ndarë në nënpjesë (*shih dokumentet nr. 1, 2, 3 dhe dosjet nr. 1, 4, 5*), ndërsa 2 në raste të tjera, arsytimi është pothuajse me tekst unik, ku ndahet vetëm pjesa arsytuese për vlerësimin e Gjykatës së Apelit Administrativ, por me paragrafë të ndarë qartë (*shih dosjet nr. 2 dhe 3*).

Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe u jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve të mosmarrëveshjes dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushtohet rëndësi analizës së normës ligjore në raport me faktet e konstatuara. Niveli i arsytimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Deri në momentin e hartimit të këtij raporti, nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga Gjykata e Lartë për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

Ai i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat ka arsyetim dhe tregohet shkak ligjor (*shih dosjet nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5*).

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit. Ai ka deklaruar se në periudhën 2014 - 2016 i janë caktuar për gjykim 3420 çështje gjyqësore dhe ka përfunduar 1687 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 49.3 %. Nga rishortimi, numri i çështjeve të caktuara në vitin 2016, nga 501 çështje është 1364 çështje dhe ka mbartur 857 çështje të vitit 2016.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Apelit për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, gjyqtari Artur Malaj ka përfunduar gjithsej 1530 çështje gjyqësore, nga të cilat 1043 administrative dhe 487 marrëdhënie pune.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjes. Në 5 dosjet e vëzhguara u konstatua se gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë në dhomë këshillimi, të cilat kanë qenë produktive. Në 3 raste tek dosjet e vëzhguara ka pasur vonesë të lartë në caktimin e seancës së parë, që ka shkaktuar cenim të standardit të procesit të rregullt (*shih dosjet nr. 1, 4 dhe 5*). Në 2 raste, seanca ka filluar me vonesë 10 -16 minuta dhe nuk është dokumentuar shkak (*shih dosjet nr. 1, 2*). Në 3 dosje që është dokumentuar ora e fillimit dhe e përfundimit të gjykimit, konstatohet se seanca ka zgjatur gjithsej 3 - 4 minuta, gjatë të cilës janë kryer të gjitha veprimet gjyqësore deri në shpalljen e vendimit (*shih dosjet nr. 1, 3 dhe 5*).

Për të 5 çështjet, subjekti i rivlerësimit ka disponuar me urdhër për caktimin e seancës në dhomë këshillimi, si dhe ka përgatitur relatimin me shkrim, referuar nenit 49/2 të ligjit nr. 49/2012. Ai ka kryer veprimet e nevojshme për caktimin e seancës gjyqësore, ka mbikëqyrur dokumentimin e veprimeve me procesverbal në dhomë këshillimi, i cili është mbajtur sipas parashikimeve të nenit 49/3 të ligjit nr. 49/2012 dhe procedurës civile. Procesverbali i seancës është i firmosur në fund të fletës nga sekretarja gjyqësore dhe në fund të tij nga trupi gjykues, ose kryesuesi dhe sekretarja gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit është kujdesur për aktet e njoftimit të palëve, të cilat janë bërë në bazë të parashikimeve të nenit 49/2 të ligjit nr. 49/2012, duke evidentuar dhe të drejtën për të dorëzuar parashtrime deri në 5 ditë para datës së shqyrtimit të çështjes, si dhe zhvillimin e gjykimit pa ndërprerje gjer në dhënien e vendimit përfundimtar.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Për veprimet e kryera është mbajtur procesverbal gjyqësor, edhe kur Kolegji ka proceduar në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve, referuar nenit 49 pika 3 të Ligjit 49/2012. *Në 2 dosje është shënuar ora e fillimit të seancës gjyqësore, por nuk është dokumentuar ora e përfundimit të saj (shih dosjet nr. 2 dhe 4). Në 2 raste seancat gjyqësore kanë filluar me vonesë 10 – 16 minuta dhe nuk është relatuar shkaku (shih dosjet nr. 1 dhe 2), megjithatë vonesa nuk ka shkaktuar pasoja të dukshme.*

Në të 5 dosjet e vëzhguara gjendet relatimi i subjektit të rivlerësimit, i nënshkruar në fund prej tij, por pa datë (*shih dosjet nr. 1, 3, 4 dhe 5*), ndërsa në 1 rast relacioni i përgatitur është nënshkruar edhe në fund të çdo flete (*shih dosjen nr. 2*). Në të 5 dosjet gjendet urdhri për caktimin e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi (*shih dosjet nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5*). Në fashikull përfshihen aktet e njoftimit të palëve (*kopje të listave të gjykimit*), të firmosura nga subjekti i rivlerësimit dhe kryetari i gjykatës. Duhet evidentuar se në asnjë rast seancat nuk kanë dështuar për shkak të njoftimeve të parregullta të palëve. Aktet e tjera të përfshira në dosje kanë qenë të sakta dhe në përputhje me kriteret e caktuara nga ligji.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjyqtari Artur Malaj është diplomuar “Jurist” nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, më datë 27.02.1999, dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2002. Pas studimeve, në datën 21.10.2002, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tepelenë dhe në datën 11.10.2003, është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Më pas, më datë 20.05.2004, është emëruar kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në vijim, më 04.11.2013 gjyqtari Artur Malaj është emëruar gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, ku vazhdon dhe aktualisht. Prej vitit 2016, ai është caktuar me short anëtar i Kolegjit Zgjedhor sipas nenit 146 të Kodit Zgjedhor. Edhe nga vëzhgimi i 3 dokumenteve ligjore dhe i 5 dosjeve është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, ushtron detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke punuar në fushën e të drejtës administrative.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Artur Malaj. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj. Për vetë gjyqtarin Artur Malaj në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, nuk ka respektuar rregullat proceduriale.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, nuk ka të dhëna për mënyrën direkte të komunikimit të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj, me palët ndërgjyqëse, pasi këto çështje janë shqyrtuar në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e palëve, megjithëse në të gjitha rastet subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues i seancës gjyqësore. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në të gjitha rastet subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale të ligjit nr. 49/2012. Në 5 dosjet është konstatuar se bashkëveprimi me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore ka qenë në nivelin e duhur, pasi nuk është konstatuar vonesë në nënshkrimin e vendimit përfundimtar dhe depozitimin e dosjes në sekretarinë gjyqësore.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Pas disa viteve nga diplomimi si “Jurist” në vitin 1999, ai ka marrë titullin “Magjistrat Gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2002. Gjithashtu ka marrë gradën shkencore “Master i nivelit të dytë” në shkenca penale, me vlerësimin “*shumë mirë*” në vitin 2011, për të vijuar më pas me gradën shkencore “Doktor” në fushën e të drejtës penale, me vlerësimin “*shumë mirë*”, më datë 19.01.2017.

Për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së dytë (administrative) që kryen, ai i nënshtrohet detyrimit programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 5 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, me temë “Zbatimi i sistemit të drejtësisë administrative në Shqipëri”, më 22 nëntor 2013; “Koncesionet”, më 05 dhjetor 2013; “Gjykimi administrativ sipas ligjit të ri nr. 49/2012”, më 23 dhjetor 2013; “Faza e ekzekutimit të procesit gjyqësor administrativ sipas ligjit të ri nr. 49/2012”, më 24 dhjetor 2013; “Kodi Administrativ”, më 10 shtator 2015. Këto të dhëna tregojnë se ai ka marrë pjesë në 5 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të gjykatës administrative të shkallës së dytë.

II. Denoncime për subjektin rivlerësimit, të ardhura pranë Komisionit

Pranë Komisionit janë depozituar 6 denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit të cilat janë marrë në shqyrtim, si më poshtë vijon:

1. Denoncimet nr. *, datë 04.12.2017 dhe nr. ***, datë 04.12.2017.**

Denoncues: A.V.

Objekti: Denoncohet ndër të tjerë, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, për marrjen e një vendimi në kundërshtim me ligjin.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin e saj nr. ***, datë 27.02.2012, me:

Paditës: A.I.

I paditur: A.V.

Objekti: Rivendosje në posedim të hotelit “****” me vendndodhje në Radhimë –Vlorë.

Baza ligjore: Nenet 31, 32, 153, 154 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 297, 299, 304, 305, 307, 309, 310 dhe 313 të Kodit Civil,

ka vendosur:

- Pranimin e padisë së paditësit A.I. Rivendosjen e paditësit A.I. në posedimin e objektit hotel - bar - restorant “****” me sip. 200 m², ndërtim me nr. pasurie *** dhe me sip. 200 m², oborr funksional i kësaj godine, i cili ndodhet në vendin e quajtur Radhimë , në afërsi të rrugës nacionale Vlorë - Sarandë.
- **Gjykata e Apelit Vlorë** me vendimin e saj nr. ***, datë 11.07.2012, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 27.02.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
- **Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë** me vendimin e tij, nr. ***, datë 27.02.2012, ka vendosur: Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur A.V., kundër vendimit nr. ***, datë 11.07.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Rasti në fjalë është analizuar dhe nga KLD-ja si organ vlerësues dhe në konkluzionin e bërë lidhur me këtë denoncim, pasi ka bërë një analizë të shkurtër lidhur me rastin dhe faktin se vendimmarrja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë. KLD-ja ka konkluduar se nuk ka vend për verifikimin e ankesës së këtij shtetasi lidhur me vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në këtë rast të gjyqtarit Artur Malaj.

Vlerësojmë se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kjo indice nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova **në lidhje me kriteret e rivlerësimit** për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj.

2. Denoncimi nr. *, datë 05.01.2018.**

Denoncues: Y.D.

Objekti: Denoncohet ndër të tjerë, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, për mungesë në motivimin ligjor në dhënien e vendimit gjyqësor si edhe për çështje etike.

Përshkrimi i denoncimit:

Denoncuesi, pretendon se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, është rrjedhë e zbatimit të gabuar të ligjit material dhe atij procedural, çka ka sjellë pasoja për të, si palë paditëse, si edhe denoncon se gjykata ka mbajtur njëanshmëri në gjykim duke favorizuar Kontrollin e Lartë të Shtetit si palë, në këtë proces gjyqësor. Gjithashtu, kjo shtetase denoncon se Gjykata Administrative e Apelit nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj, nuk është shprehur në lidhje me kushtet ligjore që duhet të plotësohen për pranimin apo rrëzimin e padisë dhe se në mënyrë *mekanike* ka përsëritur vendimin e gjykatës më të ulët.

Nga këqyrja e kësaj kërkesë, konstatohet se ajo në faqen e parë të saj reflekton faktin se i është drejtuar dhe KLD-së.

Denoncimi nuk shoqërohet me dokumente, vendimet gjyqësore përkatëse, me qëllimin verifikimin e provueshmërisë së objektit të tij.

3. Denoncimet nr. *, datë 01.12.2017, dhe denoncimi me nr. ***, datë 27.04.2018**

Denoncues: H.Q.H.

Objekti: Denoncohet ndër të tjerë, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, për dhënie të vendimeve në kundërshtim me ligjin dhe bazuar në dokumentacionin e falsifikuar.

Përshkrimi i denoncimit:

Ky denoncues pretendon se i është grabitur prona nëpërmjet vendimeve gjyqësore të bazuara në dokumente të falsifikuara.

Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët Artur Malaj, K.Gj. dhe E.T., me vendimin e tij, nr. *, datë 29.04.2008, me:**

Paditës: F.H., I.H., trashëgimtarët.

I paditur: H.H., M.H., etj.

Person i tretë: Shoqëria “*****” sh.p.k.

Objekti padisë: Pavërtetësi e faktit juridik të njohjes së pronësisë për trashëgimlënësin e të paditurit Q.S., shprehur me vendimin e vërtetimit të faktit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. ***, datë 13.10.1993, mbi një sipërfaqe toke prej 8952m², që ndodhet në lagjen “*****” Vlorë.

- Njohjen pronar të trashëgimtarëve të trashëgimlënësit G.T., mbi një shtëpi përdhese me një bahçe katër vreten tokë dhe 25 rrënjë ullinj, të ndodhur në vendin e quajtur “anë deti”, centrale, Vlorë, me kufizimet përkatëse sipas dokumenteve arkivore.

- Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke urdhëruar shoqërinë e ndërtimit “*****” sh.p.k., të ndërpresë përkohësisht punimet deri në shqyrtimin e kësaj çështjeje prej gjykatës.

- Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke urdhëruar ZVRPP-në Vlorë të bëjë bllokimin e pasurisë së paluajtshme të ndodhur në ZK ***, nr. pasurisë ***, vol. ***, faqe ***, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes.

Baza ligjore: Nenet 388 e vijues, neni 391, paragrafi i tretë, neni 32 germa “a” dhe “c”, neni 202/a e vijues, si dhe neni 205 i Kodit të Procedurës Civile.

ka vendosur:

- *Pavërtetësinë e faktit juridik të njohjes së pronësisë për trashëgimlënësin e të paditurve, Q.S., shprehur me vendimin e vërtetimit të faktit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. ***, datë 13.10.1993, mbi një sip. toke prej 8952², që ndodhet në lagjen “*****” Vlorë.*
- *Njohjen pronarë të trashëgimtarëve të trashëgimlënësit G.T., mbi një shtëpi përdhese me një bahçe katër vreten tokë dhe 25 rrënjë ullinj, të ndodhur në vendin e quajtur “anë deti”, centrale, Vlorë, me kufizimet përkatëse.*

Nga shqyrtimi i materialeve të ardhura bashkëlidhur këtij denoncimi, konstatohet se ndaj këtij vendimi pala e paditur ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Me vendimin nr. ***, datë 22.10.2009, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 29.04.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Pasi u shqyrtua denoncimi, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ***nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional, të subjektit të rivlerësimit.***

4. Denoncimi nr. *** prot., datë 19.02.2018.

Denoncues: I.A.

Objekti: Denoncohet ndër të tjerë, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, për dhënie të vendimit të padrejtë, të pabazuar në ligj si edhe zvarritje në procesin gjyqësor.

Përshkrimi i denoncimit:

Ky denoncues pretendon se gjyqtari Artur Malaj, me vendimin e tij ka hedhur poshtë vendimin e shkallës së parë duke shpallur si të padrejtë vetëm rivendosjen në afat palëve, por duke sjellë edhe njëherë themelin e formës së prerë në apelin administrativ për gjykim të dytë.

Nga verifikim i materialeve të përcjella nëpërmjet këtij denoncimi, konstatohet se trupi gjykues i Gjykatës Administrative të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët Artur Malaj (kryesues), F.P. dhe B.H. (anëtarë), me vendimin e saj nr. ***, datë 19.01.2017, me:

Kërkues: Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

Person i tretë: I.A.

Objekti padisë: Rivendosjen në afatin e ankimit.

Baza ligjore : Neni 458 i Kodit të Procedurës Civile

ka vendosur :

Prishjen e vendimit nr. ***, datë 21.07.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe pushimin e gjykimit.

Pasi u shqyrtua denoncimi, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ***nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional, të subjektit të rivlerësimit.***

5. Denoncimi nr. *** prot., datë 18.05.2018.

Denoncues: F.A.

Objekti: Denoncohet ndër të tjerë, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, për shkelje ligjore.

Përshkrimi i denoncimit:

Ky denoncues pretendon se z. Artur Malaj, në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka firmosur vendim ku ka legjitimuar si paditës, të vdekurin.

Pasi u shqyrtua denoncimi, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ***nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional, të subjektit të rivlerësimit.***

6. Denoncimi nr. ***, datë 18.07.2018.

Denoncues: Sh.H.

Objekti: Denoncohet ndër të tjerë, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, për dhënien e një vendimi të padrejtë.

Përshkrimi i denoncimit:

Nga verifikimi i këtij denoncimi konstatohet se, subjekti i ka bashkëlidhur denoncimit vendimin nr. ***, datë 06.07.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ku si kryesues i trupit gjykues, është subjekti i rivlerësimit, gjyqtari Artur Malaj.

Nga shqyrtimi i vendimit vërehet se, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në shqyrtimin e çështjes me palë paditëse: institucionin e Prefektit të Qarkut Tiranë; të paditur: shtetasit Sh.H. ..etj., ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 15.03.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Komisioni vlerëson se, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kjo indice nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova **në lidhje me kriteret e rivlerësimit në aspektin profesional** për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj, pasi ky vendim mund të jetë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Në përfundim të këtij hetimi, në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Artur H. Malaj, mbështetur në raportin e KLD-së, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, u konstatua se ky subjekt ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Në këto kushte, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, mund të konsiderohet “i aftë”.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

- 1.** Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
- 2.** Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
- 3.** Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit.

U shpall në Tiranë, më datë 03.08.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES

Genta TAFA (BUNGO)

ANËTAR

Suela ZHEGU

RELATOR

Pamela QIRKO

Sekretare gjyqësore

Olsida GOXHAI